Në intervistat me drejtuesit u morën parasysh formimi i tyre në nivelin Bachelor dhe Master, formimi i tyre specifik për drejtues, përvoja në punë si drejtues si dhe provoja e tyre në edukimin e vazhduar në fushën e drejtimit. Nga shqyrtimi në thellësi i intervistave gjysmë të strukturuar me grupin e drejtuesve të shkollave përkatëse u vu re se brenda përgjigjeve të tyre gjendeshin përgjigje dhe për pyetje të tjera të cilat nuk përfshiheshin në pyetësor, por ato u panë në këndvështrimin e Merriam-it si fenomen nga perspektivpozicione, role dhe funksione të ndryshme (Merriam, 2009: 199).

Për analizën e të dhënave u përcaktuan tre variablat bazë, 1- dijet dhe përvoja; 2- formimi dhe tiparet bazë si drejtues; 3-formimi i vazhduar profesional në fushën e drejtimit. Sigurisht që gjatë intervistave dolën në pah dhe variabla të tjerë përcaktues për këndvështrimin e drejtimit përmes drejtuesve të tyre, të cilat lidheshin kryesisht me krijimin e marrëdhënieve të drejtuesit me aktorët veprues dhe ndihmues në shkollë, krijimi i një klime të caktuar, komunikimi si dhe vizioni dhe pritshmëritë.

## Përvojat e drejtuesve të intervistuar

Sipas P. Karametës (2016: 6), në terma të përgjithshëm, trupa mësimore ngjan më shumë me një bashkësi individësh të izoluar profesionalisht, se sa me një organizatë profesionale të nxëni që mban e ndan

përgjegjësi të përbashkëta, që kërkon e gjen zgjidhje për arritje më cilësore të nxënësve. Nisur nga ky pohim, nga intervistat e drejtuesve të shkollave u vlerësuan arritjet e deritanishme, por njëkohësisht u evidentuan një sërë problemesh në kuadër të drejtimit të shkollave:

#### *Njohuritë dhe përvoja*

Në një vlerësim të përgjithshëm personal, njohuritë e fituara nga shkolla nuk marrin vlerë pa u testuar në praktikë. Aq e vërtetë është kjo, sa praktika e punës dhe vitet e përvojës shpesh mbivlerësohen mbi këto njohuri. Duke qenë se në praktikën shqiptare nuk ka pasur për një kohë të gjatë një shkollë të mirëfilltë (në rang universitar), për përgatitjen e drejtuesve në arsim, në emërimin e drejtuesve të shkollave përgjithësisht janë vlerësuar cilësitë si mësimdhënës, përvoja në punë dhe sigurisht dhe ndikimet politike.

Një nga elementët më të vlerësuar që vihej re në intervistat me drejtuesit e shkollave ishte pikërisht përvoja e tyre. Për disa prej drejtuesve të intervistuar, veçanërisht ata drejtues që kishin përvojë të gjatë si mësues dhe drejtues ky element ishte mjaft e rëndësishëm, fillimisht përvoja si mësues dhe më pas si drejtues. Të qenit mësues për një kohë të caktuar për ta krijuar mundësinë njohjes së një pjese të mirë të problemeve në shkollë dhe përballjen për zgjidhjen e tyre. Njëra prej drejtuesve shprehet:

Po e filloj me punën time si mësuese, për 18 vjet jam ballafaquar me probleme të shumta, por vullneti, pasioni i madh për profesionin dhe motivi për punë i ka mposhtur ato dhe ka rezultuar me suksese e me rezultate të kënaqshme.

Për të, përvoja e saj si mësuese i ka dhënë rezultate të kënaqshme si drejtuese, në veçanti në lidhje me komunitetin e nxënësve, duke i konsideruar arritjet

gjithmonë në funksion të ngritjes së vazhdueshme profesionale, duke reflektuar drejtpërdrejt te nxënësit:

Kurse sot ne rolin e drejtueses sukseset dhe rezultatet e nxënësve tanë, si në shkollat e mesme dhe në universitete, po na nderojnë dhe po na bëjnë të lumtur. Pra, pas një pune të ngjeshur, shohim arritjet e nxënësve, frytet e këtij mudi dhe kjo të jep kënaqësi dhe të bën të ndihesh krenar. Mendoj se kam kryer punën time me përgjegjësi të lartë morale e profesionale, gjithnjë në funksion të zhvillimit profesional të nxënësve dhe drejt ngritjes së cilësisë në arsim.

Ndërsa për një drejtues tjetër, jo vetëm duhet të kesh përvojë si mësues, por duhet të kesh qenë dhe mësues cilësor: “Të rritesh profesionalisht si drejtues do të thotë të kesh një përvojë pune si mësues, madje të kesh qenë mësues cilësor. Në drejtim, që të jesh i suksesshëm, të gjithë parametrat e shkollës duhet të jenë prekur dhe ndërjerë personalisht”

#### *Bashkëpunimi apo modeli i ofruar nga drejtuesi kryesor*

Disa prej drejtuesve të intervistuar kanë pasur më përpara përvoja drejtimi në shkollë më të ulëta (zëvendësdrejtor apo përgjegjës shkollë vartëse) dhe vlerësonin shumë qoftë përballjen me një pjesë të problemeve të drejtimit për të cilat mbanin përgjegjësi, por pse jo dhe ato të drejtorit të shkollës. Një nga drejtuesit shprehet se:

... të qenit si zëvendësdrejtor për shumë vite (12 vite) ka pasuruar përvojën time në aspektin komunikativ dhe metodik. Të komunikosh me një numër shumë të madh mësuesish për proceset e përditshme është një lloj bashkëveprimi që të bën produktiv. Të dëgjosh me qindra orë mësimore, të hapura ose jo, do të thotë se ke vjelë shumë eksperiencë pozitive nga mësues vërtet

profesionistë, por edhe të rinj që sjellin risi në procesin e edukimit, mësimdhënies dhe të nxënit kritik e krijues.

*Të mësuarit nga sfidat mund të konsiderohet si pjesë e përvojës*

Në këtë këndvështrim një pjesë e mirë e drejtuesve të intervistuar, të qenit drejtues e kanë parë si një sfidë, e cila u është dashur ta përballojnë në mënyra të ndryshme. Një prej dejtuesve të reja në detyrë thekson:

Përvoja ime si drejtuese nuk është shumë e gjatë. Megjithatë mendoj se gjatë këtyre tri viteve çdo ditë ka qenë një eksperiencë e re. Çdo ditë të duhet të përballësh me një sërë problemesh, të cilat ndonjëherë duan zgjidhje të menjëhershme dhe në këto raste duhet një intuitë e mprehtë për të bërë zgjedhjen e duhur. Kanë qenë pikërisht këto situata të vështira, që ndonjëherë duken edhe të pazgjidhshme, që më kanë rritur profesionalisht.

Ndërkohë që një prej të intervistuarve, me përvojë të gjatë në drejtim në nivele të ndryshme, e ka parë si sfidë që i ka dhënë mundësi të punojë më fort përballja me një staf mësuesish, ku pjesa më e madhe kishin më tepër se 10 vjet përvojë pune si mësues. Ai shprehet:

Një sfidë tjetër shumë e mprehtë ka qenë puna si zëvendësdrejtor i Arsimit Fillor për herë të parë në shkollën ..., viti 2001-2002. Aty u përballa me një grup mësuesish, shumica me përvojë (10 mësues kishte Cikli i Ulët atëherë), të cilët punonin me ndërgjegje, me përkushtim, por nuk koordinoheshin dot me njëri-tjetrin, me një fjalë kishin shumë përçarje dhe qejfmbetje nga njëri-tjetri.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e moskoordinimit të punëve brenda ciklit fillor nga drejtuesja e mëparshme, e një gjendjeje apatie në thelb, madje edhe selektiviteti apo preferencat nuk mungonin.”

Nisur nga gjendja që kishte gjetur, por dhe nga fakti që për problemet e një cikli nuk merrej personi i duhur, përvojën e parë të drejtimit e konsideroi si një sfidë personale:

Me problemet e arsimit fillor kryesisht merrej drejtori, i cili kishte mbaruar për Histori-Gjeografi (gjë e vështirë sepse shkolla ishte e madhe, me nga dy klasa paralele dhe drejtori duhet të drejtonte punët e në tërësi me stafin dhe analizat për arsimin fillor ishin të përcipta, si rrjedhim mësuesit do të trajtoheshin jo denjësisht). Pra në këtë ambient mungonte fryma e bashkëpunimit dhe fryma e skuadrës. U desh shumë punë dhe bashkëpunim që të realizojo një grup vërtet të mirë, se të tillë ishin, por edhe unë të afirmohesha mes tyre si një drejtues që di të organizojë mirë punët dhe di të ndajë mirë detyrat. Natyrisht, fitova edhe besimin e mësuesve të arsimit fillor, por edhe të tjerëve, në një kohë kur unë isha shumë më i ri prej tyre dhe me një përvojë dhjetëvjeçare si mësues, kundrejt 20 apo 30 viteve që mbartnin përvojat e tyre. U ndjeva mirë në atë grup sepse unë ia dola ta kaloj një sfidë të tillë dhe bëra të mundur harmoninë mes të gjithëve, po gjithsesi ishte një moment shumë i vështirë sepse në këtë ekip bënte pjesë edhe një mësues që kishte qenë për tre vjet mësuesi im kujdestar nga klasa VI deri në të VIII”.

Njerëzit në tërësi priren të ndjekin një model, sidomos kur janë në hapat e para të kryerjes së një pune apo të realizimit të diçkaje. Disa prej drejtuesve e kanë theksuar faktin se në punën e tyre si drejtues kanë pasur një model referimi në punën e tyre si drejtues, apo bashkëpunojnë me drejtues të tjerë të cilët i konsiderojnë si modele drejtimi. Disa kanë vlerësuar bashkëpunimin me drejtues joparagjykses për të mësuar dhe për të krijuar përvojat e tyre në drejtim: “Më është dashur të kërkoj ndihmë nga kolegë

joparagjykues sa i takon ngritjes së përvojës. Kam kërkuar ndihmë tek eprorët e mi, kam shfletuar literaturë sa i takon drejtimit”. Ajo që duhet vënë në dukje është fakti që vetë drejtuesja e thekson “joparagjykues”, ç’ka lë të kuptosh se në mjedisin e drejtimit në arsim ekziston paragjykimi i të qenit i ri në drejtim.

Shumë prej drejtuesve të intervistuar e vlerësojnë pozitive bashkëpunimin me kolegë me përvojë: “zakonisht, nisur nga kushtet, të lexuarit e të studiuarit individualist kanë bërë të mundur rritjen profesionale. Edhe komunikimi me kolegë dhe drejtues me përvojë më ka ndihmuar në eksperiencën time”.

Disa prej drejtuesve të intervistuar kanë vënë në dukje se jo gjithmonë përvoja e eprorëve të tyre ka qenë pozitive dhe më shumë u janë referuar modeleve të njerëzve të sukseshëm, pavarësisht profesionit: “gjithashtu edhe kontakti me drejtues të tjerë në shkollë (për arsye se unë kam qenë zv.drejtor pjesën më të madhe të kohës) më ka bërë që të mësoj nga gabimet dhe sfidat e tyre (Përvoja të mira nuk mbaj mend nga këta me lart). Si eksperiencë pozitive, mund të përmendim edhe lidhjet, takimet me njerëz të tjerë (jashtë shkollës sime, si njerëz të sukseshëm pavarësisht faktit të të qenit jo mësues)”.

### **Vizioni si drejtues dhe krijimi i mundësive për arritjen e tij**

Në konceptin e një drejtuesi efektiv, në intervista e realizuar u vu në dukje se drejtuesi i shkollës duhet të ketë vizion të qartë dhe aftësinë për ta realizuar atë:

*Drejtuesi efektiv ka vizion të qartë për mbarëvajtjen e shkollës në të ardhmen, planifikon me qartësi rrugën që do të përshkojë dhe përdor format e duhura për t'i vënë planet në zbatim”. Për një nga drejtuesit e intervistuar “suksesi i mësuesve dhe nxënësve*

*varet se sa mirë drejtuesi barton synimet, objektivat dhe udhëzimet dhe njëkohësisht, kontrolli sistematik i tyre”.*

Sipas një drejtuesi tjetër, të intervistuar, “drejtuesi efektiv lejon stafin e tij të ndërmarrë iniciativa dhe të vetëveprojë. Ai mbështetet tek udhëheqja strategjike dhe bëhet një person me vizione, një njeri që jep e merr informacione, që inspiron kolegët e tij”.

Të intervistuarit në përgjithësi mbështetin fort idenë që vizioni dhe puna për realizimin tij është mjaft e rëndësishme, por nuk vënë në dukje faktorët jashtë shkollës që mund të ndikojnë pozitivisht apo negativisht si mjedisi ku ndodhet shkolla, jetëgjatësia në detyrë etj.

### **Komunikimi**

Në përgjithësi, aftësia e komunikimit është konsideruar si një aftësi personale që drejtuesi duhet ta ketë. Komunikimi përfshin si rrafshin formal në nivele dhe struktura që përfshijnë detyrën funksionale të drejtuesit, po ashtu dhe rrafshin joformal, i cili presupozon që të përfshihesh në komunikim me njerëz të moshave, profesioneve, formimeve, shtresave sociale nga më të ndryshmet. Në raste të tilla merr vlerë shprehja: sipas vendit dhe kuvendi. Një drejtor e përshkroi si një cilësi që: “ju duhet të jeni në gjendje ta bëni këtë, ju duhet të jeni në gjendje të flisni, në një larmi nivelesh, dhe kështu duhet të jeni personi i njerëzve dhe thjesht të keni bisedën e vogël.”

Komunikimi mund të jetë jetik tek një drejtor që zhvillon vizionin e tij / saj gjithashtu. Një tjetër drejtor diskutoi “aftësia e tyre për të komunikuar vizionin që ata kanë për ata që i rrethojnë më duket se është një cilësi dhe karakteristikë e rëndësishme për shumicën e drejtorëve të cilësisë me të cilët kam qenë i lidhur”.

## Respekti i ndërsjellët

Komunikimi i mirë, që vjen si rrjedhim i bashkëpunimit dhe një krijimit të një klime pozitive, sjell respektin e ndërsjellët mes aktorëve që veprojnë në shkollë. Drejtuesi, sipas në vështrimin e një prej drejtuesve të intervistuar, jep shembullin, frymëzon personelin dhe nxënësit, duke ofruar modele të mira për zgjidhjen e detyrave. Sipas një drejtuesi tjetër:

Drejtori duhet të krijojë në shkollë një klimë respekti midis administratorëve, mësuesve, stafit, prindërve dhe anëtarëve të komunitetit. Nëse kjo ndodh atëhere dhe të mësuarit do të rritet në mënyrë të ndjeshme. Respekti duhet të qarkullojë në mënyrë të dyanshme”. Një drejtues thekson frymën e tolerancës brenda rregullave, sipas tij në shkollë duhet të ketë: “...një klimë miqësore jashtë dhe brenda ambienteve të shkollës, një atmosferë komunikimi brenda Kodit të Etikës, një frymë tolerance dhe mirëkuptimi me këdo.

Sipas një drejtueseje të re: “Shkolla duhet të bëjnë maksimumin për të krijuar një klimë të tillë ku nxënësit të ndjehen si në shtëpi, që favorizon të mësuarit dhe edukimin e tyre. Një klimë e mirë shkollore shihet në marrëdhëniet e mira midis mësuesve dhe nxënësve gjatë situatave mësimore si dhe midis stafit të shkollës dhe nxënësve jashtë mësimin.”

## Siguria në punë dhe mjedis frymëzues

Një mjedis i sigurt pune për mësuesit dhe nxënësit i ndërthurur me laboratorë, mjedise sportive dhe çlodhëse do të ishte ideal për të siguruar efektivitet të lartë në punën e mësuesve, një mundësi të mirë për nxënësit për ta parë shkollën si një familje dhe sigurisht një nxitje për punën

e drejtuesit për një performancë sa më të mirë të shkollës. Një nga drejtuesit thekson se vetë mjedisi edukon me ndjesinë e së bukurës dhe të veçantës dhe në të rendit:

...një mjedis i jashtëm shkollor që të tërheq nga pamja dhe sistemi i gjërave; një mjedis i jashtëm i gjelbëruar, i pastër që të imponon rregull; një mjedis i brendshëm (korridore, banja, klasa) me një higjienë shembullore; një mjedis shkollor me klasa të rregullta të dekoruara mirë dhe me laboratorë të lëndëve përkatëse që të jenë funksionale dhe në shërbim të nxënësit (këtu përfshij edhe këndet sportive dhe mjetet e nevojshme didaktike për mësimdhënie).

Sipas një drejtueseje tjetër:

Siguria dhe rregulli janë shumë të rëndësishme. Shkollat duhet të organizojnë supervizionin e nxënësve dhe të garantojnë sigurinë për pajisjet e tyre personale. Shkollat duhet të kenë rregulla të qarta të sjelljes dhe të garantojnë zbatimin e tyre korrekt”. Sipas saj është shkolla ajo që e ka për detyrë: “...të kujdeset dhe të përgatitë një mjedis mikpritës për nxënësit; të organizojë veprimtari për rritjen e përfshirjes së nxënësve në shkollë; të marrë masa që nxënësit të jenë të sigurtë.

Në këtë mënyrë nxënësit vlerësojnë atë që u ofron shkolla. Në vështrimin e disa drejtuesve kjo nuk është e arritshme në çdo shkollë. Shkollat në disa zona rurale, larg qytetit, nuk i plotësojnë këto kushte: “Kushtet e shkollës sonë nuk i përmbushin tërësisht karakteristika të një mjedisi efektiv. Para shkollës dalin sfida që e vështirësojnë mundësinë për të qenë një shkollë efektive”.

## Përfundime

“Drejtuesi është qendra nervore e përmirësimit të shkollës. Kur lidershipi

kryesor është i fortë, edhe shkollat më të sfiduara lulëzojnë. Kur lidershipi është e dobët shkollat dështojnë ose shkojnë më keq” (Fullan, 2004). Duke pasur parasysh këtë përfundim të njërit prej studiuesve që ka bërë një kthesë të rëndësishme në edukimin e sotëm, në studimin fenomenologjik i ndërmarrë me disa prej drejtuesve të rrethit të Korçës janë arritur disa përfundime:

1. Nëse u referohemi të dhënave nga intervistat mund të theksojmë se nga këndvështrimi i drejtuesve të shkollave u vu në dukje se koncepti i përvojës në punë ishte një nga elementët që e bënte një drejtues efektiv. Ata drejtues që fillimisht kishin qenë nëndrejtorë dhe më pas drejtorë e konsideronin një përvojë mjaft të rëndësishme në punën e tyre. Kjo ide përforcohet dhe nga gjetjet e Raportit Kombëtar “Identifikimi i nevojave për trajnim e drejtuesve dhe mësuesve të shkollave në arsimin parauniversitar” ku theksohet se “Nëndrejtorët janë kategoria e punonjësve arsimorë që kanë rezultate më të larta, krahasuar me drejtorët dhe me mësuesit” (Karameta, 2016: 7).

2. Fakti që për fushën e zhvillimit profesional, në raportin kombëtar tregon se 5 DAR-et që kishin mesatare pikësh më të lartë se mesatarja në nivel kombëtar (këtu përmendim DAR-et: Berat, Shkodër, Tirana Qark, Fier), përfshihej dhe DAR Korçë (2016: 27), tregon për një punë të mirë të mësuesve dhe drejtuesve së pari në nivel individual. Nga intervistat u vu në dukje se pavarësisht aftësive personale, zhvillimi i vazhdueshëm profesional ishte mjaft i rëndësishëm në rritjen efektivitetit të drejtimit të shkollës.

Formatet në të cilat drejtuesit janë angazhuar në bazë të këtyre dy drejtimeve ishin të larmishme dhe gjithëpërfshirëse, projekte të përbashkëta kombëtare ose rajonale, bashkëpunimit lokal, vizitat shkollore, ndarja përvojave përmes organizimit të orëve të hapura nëpër shkolla, takimeve në kuadër të vlerësimit të performancës së shkollës të organizuara në nivel lokal dhe kombëtar etj. Nga ana tjetër nuk mungonte dëshira për studim individual përmes literaturës që lidhej me drejtimin apo përmirësimin të aftësive personale në teknologji dhe gjuhë të huaja.

## REFERENCAT

- Fullan, M. (2004). “Leadership and sustainability: System thinkers in action”. *Thousand Oaks, CA: Corwin Press*
- Karameta, P. (2016). “Drejtimesit shkollorë në Shqipëri: Përvoja dhe sfida”, *Revista Arsimi Sot*, (3), 5-15.
- Leithwood, K. (2012). “The Ontario leadership framework 2012: With a discussion of the research foundations”, Ontario Institute for Education Leadership.
- Leithwood, K., Jantzi, D. Earl, L. Watson, N., Fullan, M. (2004). “Strategic leadership on a large scale: the case of England’s National Literacy and Numeracy Strategies”, *Journal of School Management and Leadership*, 24 (1), 57-7
- Merriam, S. B. (2009). *Qualitative research: A guide to design and implementation*. San Francisco, CA: John Wiley & Sons.
- Pendavinji, Gj., & Jorgji, S. (2006). “Roli i aftësive politike në kuadrin e aftësive të Drejtimit”

**ABSTRACT**

---

This study examines the role of political skills in leadership, with a particular focus on educational institutions. Research in this field has shown that political skill is a key prerequisite for success, both for leaders and for the organizations they manage. In the 21st century, societies and institutions require a new generation of leader individuals capable of managing uncertainty, adapting to unstable circumstances, and demonstrating resilience and determination rather than resignation. Empirical studies indicate that many individuals' express dissatisfaction with the current state of schools, largely due to constant reforms and policy changes affecting the education system. These ongoing transformations have influenced school organizational dynamics, reshaping staff roles and institutional functions. Within this context, the ability to influence, motivate, and engage subordinates in achieving a shared vision emerges as a critical leadership competence. The purpose of this study is to determine the impact of school leaders' political skills on fostering a friendly and collaborative climate within educational institutions.

**Keywords:** *Political skill, educational leadership, organizational climate, collaboration, influence*

# QYTETARI DHE LIDERSHIPI POLITIK: DREJT STRUKTURËS SË KULTURËS POLITIKE TË SHQIPTARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Ariton RAMA

*Universiteti i Evropës Juglindore (SEEU), Maqedoni e Veriut*

E-mail: a.rama@seeu.edu.mk

---

## PËRMBLEDHJE<sup>1</sup>

Kultura politike përfaqëson një dimension kompleks të marrëdhënies ndërmjet individit dhe sistemit politik, duke reflektuar jo vetëm botëkuptimet dhe perceptimet politike, por edhe mënyrat se si këto përkthehen në veprim dhe pjesëmarrje qytetare. Në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku modeli i qeverisjes ndërtohet mbi parimet e ndarjes së pushtetit, partneriteti ndërmjet qytetarëve dhe lidershit politik shfaqet si një element kyç në strukturimin e kësaj kulture. Megjithatë, kjo marrëdhënie shpesh karakterizohet nga një mospërputhje ndërmjet atyre që prodhojnë politikë dhe atyre që i nënshtrohen asaj. Veçanërisht brenda komunitetit shqiptar, pjesëmarrja dhe profilizimi politik mbeten më pak të kushtëzuara nga ndarjet klasike ideologjike (majtas–djathtas) dhe më shumë nga faktorë etnikë, socialë, komunitarë dhe fetarë, duke krijuar një formë të veçantë të mentalitetit politik. Ky studim synon të shqyrtojë në çfarë mase partneriteti qytetar–lidërsip ndikon në konsolidimin e kulturës politike në Maqedoninë e Veriut, duke analizuar nivelet e përfshirjes së shqiptarëve në proceset politike, perceptimet e tyre mbi përfaqësimin, si dhe rolin e opinionit publik si instrument i një demokracie funksionale. Rezultatet e pritura synojnë të kontribuojnë në një kuptim më të gjerë

---

<sup>1</sup> Ky punim është prezantuar në konferencën ndërkombëtare e ndërdisiplinore “Zhvillimi në kohë të trazuar” [Development in Turbulent Times], mbajtur në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, më 14-15 nëntor 2025; Proceedings, fq. 81-82, link: [https://www.sociology.al/sites/default/files/20th%20Annual%20International%20%26%20Interdisciplinary%20Conference%20UNISHKODRA%202025\\_0.pdf](https://www.sociology.al/sites/default/files/20th%20Annual%20International%20%26%20Interdisciplinary%20Conference%20UNISHKODRA%202025_0.pdf)

të sfidave dhe mundësive për zhvillimin e një kulture politike gjithëpërfshirëse, e cila tejkalon logjikën e përkatësive komunitare dhe orienton drejt një modeli më demokratik të pjesëmarrjes qytetare.

**Fjalë kyçe:** *kulturë politike, partneritet qytetar-lidership, ndarja e pushtetit, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, pjesëmarrja qytetare, opinioni publik.*

**Ariton RAMA** është asistent dhe hulumtues në fushën e shkencave politike dhe politikave publike në Universitetin e Evropës Juglindore, si dhe i angazhuar si asistent profesor në aktivitete akademike dhe kërkimore në Universitetin “Nënë Tereza”. Fusha e tij e interesimit përfshin kulturën politike, pjesëmarrjen politike, identitetin politik, politikat publike dhe marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoninë e Veriut dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktualisht është në përfundim të studimeve të doktoraturës me fokus në profilizimin partiak dhe pjesëmarrjen politike të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në Universitetin e Evropës Juglindore, ndërsa studimet bachelor dhe master i ka përfunduar në Universitetin e Tetovës në katedrën e shkencave politike. Përveç angazhimit akademik, ai është aktiv në organizimin e aktiviteteve universitare, debateve publike dhe projekteve që lidhen me edukimin qytetar, diplomacinë akademike dhe zhvillimin e politikave publike.

## Hyrje

Kultura politike, si një koncept qendror në shkencat politike, përfaqëson tërësinë e vlerave, besimeve, qëndrimeve dhe orientimeve që individët dhe grupet shoqërore zhvillojnë ndaj sistemit politik dhe institucioneve të tij. Në literaturën klasike, studiues si Gabriel Almond dhe Sidney Verba e kanë konceptualizuar kulturën politike si një faktor përcaktues për stabilitetin dhe funksionalitetin e demokracisë, duke theksuar rëndësinë e përpunimit ndërmjet strukturave institucionale dhe orientimeve qytetare. Sipas tyre, një kulturë politike pjesëmarrëse (participant political culture) është thelbësore për zhvillimin e një sistemi demokratik të qëndrueshëm, pasi ajo nxit angazhimin aktiv të qytetarëve në proceset politike (Almond, 1989).

Në këtë kuadër, marrëdhënia ndërmjet qytetarit dhe lidhshipit politik merr një rëndësi të veçantë, pasi ajo përfaqëson një dimension kyç të ndërveprimit ndërmjet shoqërisë dhe shtetit. Kjo marrëdhënie nuk është statike, por zhvillohet dhe transformohet në varësi të kontekstit historik, institucional dhe kulturor. Në shoqëritë pluraliste dhe multietnike, siç

është rasti i Maqedonia e Veriut, kjo marrëdhënie ndërlikohet edhe më tej për shkak të nevojës për balancim ndërmjet identiteteve kolektive dhe ndërtimit të një identiteti qytetar të përbashkët. Modeli i qeverisjes në këtë shtet bazohet në parimet e ndarjes së pushtetit dhe përfaqësimit të komuniteteve etnike, duke reflektuar një formë të demokracisë konsociative, e cila synon të garantojë stabilitet dhe përfshirje politike. Megjithatë, siç theksojnë autorë si Arend Lijphart, ky model, ndonëse i dobishëm për menaxhimin e diversitetit, mund të prodhojë gjithashtu efekte anësore, si fragmentimi politik dhe dominimi i identiteteve kolektive mbi ato qytetare. Në këtë kontekst, kultura politike shpesh formësohet jo vetëm nga faktorë ideologjikë, por edhe nga përkatësitë etnike, sociale dhe kulturore (Lijphart, 1989).

Në mënyrë të veçantë, komuniteti shqiptar në Maqedoninë e Veriut paraqet një rast interesant për analizë, pasi pjesëmarrja dhe orientimi politik shpesh nuk ndjekin linjat tradicionale ideologjike majtas–djathtas, por ndikohen nga faktorë të tjerë strukturorë dhe identitarë. Kjo krijon një formë specifike të kulturës politike, ku raporti ndërmjet qytetarëve

dhe elitave politike shpesh karakterizohet nga nivele të ndryshme besimi, mobilizimi dhe përfaqësimi

Për më tepër, në praktikë vërehet një hendek i dukshëm ndërmjet prodhuesve të politikave (elitave politike) dhe qytetarëve që janë subjekt i tyre. Ky hendek reflektohet në perceptimet për mungesë përfaqësimi të drejtë, në uljen e besimit ndaj institucioneve dhe në pjesëmarrjen e kufizuar qytetare në proceset vendimmarrëse. Në këtë drejtim, roli i opinionit publik si një mekanizëm kontrolli dhe ndikimi në politikë bëhet thelbësor për funksionimin e një demokracie efektive (Inglehart, 2005).

Duke u mbështetur në këto premisa teorike dhe empirike, ky punim synon të analizojë në çfarë mase partneriteti ndërmjet qytetarëve dhe lidërshiptit politik ndikon në konsolidimin e kulturës politike në Maqedoninë e Veriut. Fokus i veçantë do t'i kushtohet nivelit të përfshirjes së shqiptarëve në proceset politike, perceptimeve të tyre mbi përfaqësimin dhe rolin të opinionit publik në ndërtimin e një demokracie funksionale. Në këtë mënyrë, studimi synon të kontribuojë në kuptimin e sfidave dhe mundësive për zhvillimin e një kulture politike më gjithëpërfshirëse, e cila tejkalon kufizimet e përkatësive komunitare dhe promovon një model më të avancuar të pjesëmarrjes qytetare

### **Kultura politike dhe determinantët e profilizimit politik në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Kultura politike përfaqëson një dimension kompleks të marrëdhënies ndërmjet individit dhe sistemit politik, duke reflektuar jo vetëm botëkuptimet dhe perceptimet politike, por edhe mënyrat në të cilat këto përkthehen në veprim konkret dhe pjesëmarrje qytetare. Në kontekstin e

Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku modeli i qeverisjes ndërtohet mbi parimet e ndarjes së pushtetit dhe përfaqësimit të komuniteteve, partneriteti ndërmjet qytetarëve dhe lidërshiptit politik paraqitet si një element thelbësor për formësimin dhe funksionimin e kulturës politike.

Megjithatë, kjo marrëdhënie shpesh karakterizohet nga një mospërputhje ndërmjet atyre që prodhojnë politika dhe qytetarëve që i përjetojnë ato në praktikë. Ky hendek reflektohet në nivelet e besimit institucional, në perceptimet mbi përfaqësimin dhe në shkallën e pjesëmarrjes qytetare. Në mënyrë të veçantë, brenda komunitetit shqiptar, pjesëmarrja dhe profilizimi politik mbeten më pak të kushtëzuara nga ndarjet klasike ideologjike (majtas–djathtas) dhe më shumë nga faktorë etnikë, socialë, komunitarë dhe fetarë, duke ndikuar drejtpërdrejt në formësimin e një kulture politike specifike.

Në këtë kuadër, analiza e determinantëve të profilizimit politik bëhet thelbësore për të kuptuar mënyrën se si ndërtohet marrëdhënia qytetar–lidërshipt dhe si kjo marrëdhënie ndikon në konsolidimin e kulturës politike. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, komuniteti shqiptar ka një rol të rëndësishëm në jetën politike, si përmes përfaqësimit institucional ashtu edhe përmes pjesëmarrjes në proceset zgjedhore dhe në sistemin partiak. Megjithatë, kjo pjesëmarrje nuk është gjithmonë e shoqëruar me një nivel të lartë ndikimi në vendimmarrje, duke ngritur pikëpyetje mbi cilësinë e përfaqësimit dhe efektivitetin e partneritetit politik. Orientimi politik i elektoratit shqiptar ndikohet nga një sërë faktorësh të ndërlikuar, duke përfshirë identitetin etnik, zhvillimet historike, interesat socio-ekonomike dhe ndikimin e elitave politike. Në këtë kontekst, kultura politike duhet të kuptohet si një proces

dinamik, i cili formësohet nga ndërveprimi i vazhdueshëm ndërmjet përvojave individuale, strukturave institucionale dhe diskursit publik. Kjo qasje e zhvendos analizën nga një kuptim statik drejt një perspektive funksionale, ku qytetari shihet si aktor aktiv në ndërtimin e realitetit politik (Berishaj, 2010: 31).

Formësimi i mendësisë politike fillon në nivel individual, përmes përvojave të përditshme dhe ndërveprimit social, dhe më pas konsolidohet në bindje politike më të qëndrueshme. Në një shoqëri multietnike si ajo e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ky proces ndikohet fuqishëm nga përkatësitë etnike, fetare, kulturore dhe socio-ekonomike, të cilat shpesh veprojnë si faktorë konkurrues në ndërtimin e identitetit politik të individit. Këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si qytetarët e perceptojnë rolin e tyre në sistemin politik dhe në nivelin e angazhimit të tyre.

Në këtë drejtim, fokusi i këtij hulumtimi vendoset te analiza e aktivizmit politik dhe orientimit partiak të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke e lidhur këtë drejtpërdrejt me cilësinë e partneritetit ndërmjet qytetarëve dhe lidhshiptit politik. Studimi synon të identifikojë nëse ekzistojnë kriteret të qarta për profilizimin politik dhe cilët janë mekanizmat që mundësojnë ose kufizojnë përfshirjen e individëve në jetën politike (Berishaj, 2010: 31).

Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu formave të pjesëmarrjes qytetare. Edhe pse vërehen angazhime në nivel lokal dhe komunitar, shpesh evidentohet një hezitim në forma më të drejtpërdrejta të pjesëmarrjes politike, si protestat, debatet publike apo aktivizmi qytetar. Kjo tregon për një nivel të kufizuar të funksionimit të partneritetit qytetar–lidhshipi dhe për nevojën e forcimit të mekanizmave

demokratikë që mundësojnë përfshirje më të gjerë dhe më efektive (Berishaj, 2010: 32).

Një tjetër dimension i rëndësishëm lidhet me qartësinë ideologjike dhe kapacitetin e elektoratit për të ndikuar në formësimin e politikave publike. Në këtë kontekst, lindin pyetje thelbësore mbi nivelin e ndërgjegjësimit politik, rolin e opinionit publik dhe ndikimin real të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Po ashtu, roli i mediave dhe komunikimit politik mbetet i rëndësishëm në formësimin e perceptimeve dhe orientimeve politike.

### **Ndërveprimi ndërmjet politikës dhe kulturës politike në formësimin e mendësisë politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Kultura politike, pavarësisht mënyrës së përkufizimit të saj në literaturën shkencore, mbetet një koncept kompleks që pasqyron ndërveprimin e vazhdueshëm ndërmjet politikës dhe kulturës si dy sfera të ndërlidhura të jetës shoqërore. Edhe pse në plan konceptual ato mund të shihen si të dallueshme, në praktikë politika dhe kultura politike janë reciprokisht të varura dhe plotësojnë njëra-tjetrën në procesin e formësimin të mendësisë politike të individëve dhe grupeve shoqërore. Në këtë kuptim, kultura politike manifestohet përmes një raporti komunikues dhe funksional që mundëson inkorporimin e individit në jetën politike.

Në këtë kuadër, politika e kulturës mund të kuptohet si tërësia e marrëdhënieve që shoqëria e organizuar ndërton ndaj kulturës. Kjo nuk kufizohet vetëm në dimensionin formal institucional apo në politikat publike, por përfshin edhe aspektet simbolike, normative dhe identitare që ndikojnë në formësimin e sjelljes kolektive dhe në orientimin politik

të qytetarëve. Në këtë mënyrë, politika shfaqet si një proces dinamik, në të cilin kultura luan një rol aktiv në ndërtimin e identiteteve sociale dhe në orientimin e veprimit politik.

Politika kulturore, si një komponent thelbësor i sistemit politik, nënkupton angazhimin e vazhdueshëm të shoqërisë për krijimin, zhvillimin dhe komunikimin e vlerave kulturore në mënyrë të lirë dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nuk duhet të reduktohet në një mekanizëm burokratik apo administrativ, por të funksionojë si një hapësirë dinamike ndërveprimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm shoqërorë, ku kultura zhvillohet në mënyrë organike dhe në përputhje me nevojat e komunitetit.

Në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, një shoqëri multietnike dhe multikulturore, kjo qasje merr një rëndësi të veçantë. Ndërveprimi ndërmjet identiteteve etnike, fetare dhe kulturore krijon një terren kompleks për formësimin e kulturës politike, ku faktorët identitarë shpesh ndërthuren me strukturat institucionale dhe proceset politike. Në këtë drejtim, kultura politike nuk është thjesht një reflektim i strukturave ekzistuese, por edhe një faktor aktiv që ndikon në transformimin e tyre.

Një aspekt i rëndësishëm në këtë analizë është refuzimi i burokratizimit të kulturës, i cili mund të kufizojë pluralizmin dhe të reduktojë diversitetin e shprehjeve kulturore. Ndërhyrjet e tepruara institucionale rrezikojnë ta transformojnë kulturën në një instrument formal dhe të standardizuar, duke dobësuar rolin e saj si një hapësirë e lirë e shprehjes dhe krijimtariisë. Përkundrazi, një politikë kulturore funksionale duhet të sigurojë një balancë ndërmjet mbështetjes institucionale dhe autonomisë kulturore, duke e vendosur shtetin në rolin e një lehtësuesi dhe jo imponuesi të proceseve

kulturore. Në çdo shoqëri të organizuar, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, ekzistojnë interesa të ndryshme të individëve, grupeve dhe shtresave shoqërore, të cilat shpesh janë në konflikt me njëra-tjetrën.

Në këtë kontekst, kultura politike dhe politika kulturore luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e këtyre dallimeve, duke kontribuar në krijimin e një hapësirë dialogu dhe bashkëkrijimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm shoqërorë (Agani, 2002: 167).

Në nivel teorik, kjo qasje lidhet me perspektivat bashkëkohore që e shohin kulturën si një fushë të negociimit të kuptimeve dhe identiteteve, ndërsa politikën kulturore si një instrument për demokratizimin e hapësirës publike dhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare. Në këtë mënyrë, kultura politike shndërrohet në një element kyç për zhvillimin demokratik, duke kontribuar në tejkalimin e ndarjeve tradicionale dhe në promovimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse. Në përfundim, kultura politike mund të konsiderohet si një faktor thelbësor në procesin e demokratizimit shoqëror dhe shtetëror. Përmes saj, bëhet e mundur tejkalimi i ndarjeve klasike dhe promovimi i një kulture më të gjerë pjesëmarrëse, ku qytetarët nuk janë vetëm subjekte pasive, por aktorë aktivë në ndërtimin e jetës politike dhe shoqërore (Agani, 2002: 167).

### **Transformimet e kulturës politike në profilizimin partiak të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Identiteti përbën një nga konceptet më komplekse dhe më të rëndësishme në Shkenca Politike, veçanërisht në analizën e kulturës politike dhe të marrëdhënieve ndëretnike në shoqëritë

multietnike dhe multikulturore. Në kontekstin bashkëkohor, identiteti nuk trajtohet më si një kategori e ngurtë dhe e pandryshueshme, por si një konstrukt social dinamik, i cili formësohet, transformohet dhe rikonfigurohet në varësi të zhvillimeve historike, politike dhe shoqërore. Në këtë kuptim, identiteti shfaqet njëkohësisht si proces i afirmimit, krizës dhe ripërcaktimit të vazhdueshëm të përkatësisë kolektive (Meyer, 2009: 49).

Në aspektin teorik, identiteti nënkupton mënyrën se si individët dhe grupet shoqërore e kuptojnë veten dhe e dallojnë veten nga “tjetri”. Uni apo identiteti individual nuk mundë të formohet si i pavarur nga identiteti kolektiv i bashkësisë apo shoqërisë. Ai është një gjë të cilën njeriu e fiton, e ndërton duke krijuar marrdhënie dhe duke hyrë në ndërveprime të caktuara shoqërore. Ai ndërtohet duke i përvetësuar vlerat themelore kulturore të një mjedisi të caktuar. Meqenëse identiteti ndërtohet apo oformohet përmes ndërveprimit me të tjeret, “tjetri” në këtë rast paraqitet si parakusht i domosdoshëm për formimin e unit apo identitetit. “Tjetri” siç argumenton Jacques Derrida, përbën kushtin e parë për formimin e identitetit (Aliu, 2024: 46). Ai lidhet ngushtë me procesin e vetidentifikimit kolektiv, ku gjuha, kultura, historia, feja dhe simbolet kombëtare luajnë rol qendror në formësimin e vetëdijes politike. Në këtë kuadër, identiteti nuk është vetëm kategori kulturore, por edhe faktor politik që ndikon drejtpërdrejt në orientimet ideologjike dhe në sjelljen elektorale të qytetarëve (Sulejmani, 2020: 118).

Në shoqëritë multietnike si ajo e Republikës së Maqedonisë së Veriut, identiteti merr karakter të dyfishtë: nga njëra anë është relacional, pasi ndërtohet përmes ndërveprimit social, dhe nga ana tjetër kategorial, pasi lidhet me përkatësi të

qarta etnike, gjuhësore dhe kulturore. Në këtë kontekst, marrëdhëniet ndëretnike dhe proceset politike pas pavarësimit të shtetit kanë ndikuar fuqishëm në formësimin e kulturës politike dhe në strukturimin e profilizimit partiak (Sulejmani, 2014: 13).

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe konsolidimit të shtetit të pavarur, Republika e Maqedonisë së Veriut është përballur me sfida të shumta në ndërtimin e një modeli funksional multietnik. Këto sfida u theksuan veçanërisht gjatë konfliktit të vitit 2001, i cili përfundoi me Marrëveshjen e Ohrit, duke synuar rregullimin institucional të të drejtave të komuniteteve dhe krijimin e një modeli më gjithëpërfshirës të qeverisjes. Megjithatë, pavarësisht këtij progresi institucional, nacionalizmi etnik ka vazhduar të mbetet një faktor i rëndësishëm në jetën politike dhe në formësimin e kulturës politike (Xhaferi, 2014).

Në këtë kuadër, profilizimi partiak i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut shpesh nuk është rezultat vetëm i ndarjeve ideologjike tradicionale, por edhe i faktorëve identitarë, historikë dhe socio-politikë. Nacionalizmi, si formë e artikullimit politik të identitetit, ka ndikuar në mënyrën se si qytetarët shqiptarë e perceptojnë përfaqësimin politik dhe në mënyrën se si orientohen drejt subjekteve politike. Kjo tregon se kultura politike në këtë kontekst është thellësisht e ndërlidhur me identitetin etnik dhe përvojat historike të komunitetit (Xhaferi, 2014).

Në një perspektivë më të gjerë teorike, globalizimi dhe transformimet bashkëkohore kanë sjellë në pah rëndësinë e identiteteve kulturore si faktorë të pavarur në politikë. Konfliktet bashkëkohore dhe zhvillimet ndërkombëtare kanë treguar se përplasjet ndërmjet identiteteve shpesh qëndrojnë në thelb të dinamikave politike dhe shoqërore. Në këtë mënyrë, kultura

politike nuk mund të kuptohet jashtë ndikimit të identiteteve kolektive dhe proceseve të nacionalizmit.

Në shoqëritë multikulturore bashkëkohore, diversiteti kulturor është bërë një realitet politik i pashmangshëm, i cili ndikon në çështje si gjuha, përfaqësimi politik, arsimi, shpërndarja e resurseve dhe simbolet shtetërore. Në këtë kontekst, Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me nevojën për të balancuar ndërmjet ruajtjes së identiteteve të veçanta dhe ndërtimit të një kohezioni të përbashkët qytetar. Rrjedhimisht, identiteti etnik dhe nacionalizmi mbeten faktorë kyç në formësimin e kulturës politike dhe në profilizimin partiak të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën e pjesëmarrjes politike, në orientimin elektoral dhe në strukturimin e vetëdijes kolektive, duke e bërë kulturën politike një fushë dinamike ndërveprimi ndërmjet identitetit dhe politikës.

## Përfundime

Ky punim ka trajtuar në mënyrë analitike ndërveprimin ndërmjet kulturës politike, identitetit etnik dhe nacionalizmit në procesin e profilizimit partiak të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke u mbështetur në qasje teorike të shkencave politike dhe në kontekstin specifik të një shoqërie multietnike, është synuar të shpjegohet mënyra se si formësohet mendësia politike, si strukturohet sjellja elektorale dhe si ndërtohet raporti ndërmjet qytetarëve dhe lidershit politik. Një përfundim themelor i këtij studimi është se kultura politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk mund të kuptohet jashtë ndikimit të fuqishëm të faktorëve identitarë. Në vend të një modeli të pastër ideologjik të ndarjes

politike (majtas–djathtas), vërehet një model i ndërthurur, ku përkatësia etnike, lidhjet komunitare, faktorët historikë dhe perceptimet mbi përfaqësimin politik luajnë rol dominues në orientimin politik të qytetarëve. Kjo është veçanërisht e dukshme te komuniteti shqiptar, ku identiteti etnik shpesh funksionon si një kornizë kryesore për vendimmarrjen politike dhe për profilizimin partiak.

Nga analiza rezulton se nacionalizmi, si fenomen politik dhe shoqëror, ka ndikuar ndjeshëm në strukturimin e kulturës politike në vend. Ai nuk shfaqet vetëm si ideologji politike, por edhe si mekanizëm mobilizimi dhe identifikimi kolektiv, i cili ndikon në mënyrën se si qytetarët e perceptojnë shtetin, institucionet dhe proceset demokratike. Në këtë kuptim, nacionalizmi ka luajtur rol të dyfishtë: nga njëra anë ka kontribuar në artikullimin e kërkesave për përfaqësim dhe barazi, ndërsa nga ana tjetër ka thelluar ndarjet identitare në hapësirën politike.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm është se marrëdhënia ndërmjet qytetarëve dhe lidershit politik në Maqedoninë e Veriut karakterizohet nga një nivel i moderuar deri i ulët i besimit institucional. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e pjesëmarrjes qytetare dhe në funksionimin e demokracisë përfaqësuese. Në shumë raste, qytetarët perceptojnë politikën si një proces të distancuar nga interesat e tyre reale, gjë që krijon një hendek ndërmjet elitave politike dhe shoqërisë civile.

Në rastin e shqiptarëve, profilizimi politik shpesh lidhet me faktorë që tejkalojnë dimensionin thjesht ideologjik. Përkatësia etnike, përvoja historike, statusi socio-ekonomik dhe ndikimi i elitave politike janë ndër faktorët kryesorë që përcaktojnë orientimin politik. Në këtë mënyrë, kultura politike merr një karakter më shumë identitar sesa programor, duke

ndikuar në mënyrën se si organizohet konkurrenca politike dhe si strukturohet sistemi partiak.

Gjithashtu, studimi tregon se pjesëmarrja qytetare në proceset politike nuk është homogjene dhe shpesh kufizohet në format tradicionale të angazhimit, siç është pjesëmarrja në zgjedhje. Format më aktive të pjesëmarrjes, si aktivizmi qytetar, debatet publike apo protestat, mbeten më pak të zhvilluara ose të kushtëzuara nga faktorë të ndryshëm socialë dhe politikë. Kjo tregon se kultura politike pjesëmarrëse ende nuk është konsoliduar plotësisht.

Në këtë kontekst, roli i mediave dhe diskursit politik është gjithashtu thelbësor, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në formësimin e opinionit publik dhe në mënyrën se si qytetarët i perceptojnë aktorët politikë dhe proceset demokratike. Informimi i pjesshëm, polarizimi mediatik dhe ndikimi i narrativave politike shpesh kontribuojnë në përforcimin e ndarjeve ekzistuese në shoqëri.

Në aspektin teorik, analiza e kryer konfirmon se identiteti politik nuk është një kategori statike, por një proces dinamik që formësohet në ndërveprim të vazhdueshëm ndërmjet individit,

shoqërisë dhe institucioneve. Në këtë kuptim, kultura politike në Maqedoninë e Veriut duhet të kuptohet si një hapësirë e negociimit të vazhdueshëm ndërmjet identiteteve të ndryshme dhe strukturave institucionale të shtetit.

Në përfundim të përgjithshëm, mund të theksohet se zhvillimi i një kulture politike më funksionale dhe gjithëpërfshirëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut kërkon forcimin e disa elementeve kyçe: rritjen e besimit institucional, përmirësimin e përfaqësimit politik, depolitizimin e disa dimensioneve të identitetit etnik në proceset zgjedhore dhe zgjerimin e formave të pjesëmarrjes qytetare. Vetëm përmes një balance të qëndrueshme ndërmjet identitetit dhe qytetarisë mund të arrihet një sistem politik më i konsoliduar dhe më demokratik. Në këtë drejtim, partneriteti ndërmjet qytetarëve dhe lidhshiptit politik mbetet faktor vendimtar për të ardhmen e kulturës politike në vend. Konsolidimi i këtij partneriteti nënkupton jo vetëm përfaqësim formal, por edhe përfshirje reale të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, gjë që do të kontribuonte në ndërtimin e një shoqërie më të qëndrueshme, më të barabartë dhe më demokratike.

## REFERENCAT

- Agani, F. (2002). *Për shoqërinë civile*. Pejë: Dukagjini.
- Aliu, M. (2024). *Pushteti, identiteti dhe hapësira*, Shkup: Logos A.
- Almond, G. A. (1989). *The Civic Culture: Political Attitudes and Democracy in Five Nations*. London: SAGE Publications.
- Arend Lijphart, A. (. (1989). *Democracy in Plural Societies*. Yale University Press. Bombay: Popular Prakashan.
- Berishaj, M. (2010). *Identiteti dhe shtetësia*. Prishtinë: Kolegji Victory.
- Inglehart, R. &. (2005). *Modernization, Cultural Change, and Democracy*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Meyer, Thomas. (2009). *Die identität Europas: Der EU eine Seele?* Frankfurt: Suhrkamo Verlag.
- Sulejmani, R. (2014). *Sfidat Shqiptare -analizë politike*. Shkup: Logos A.
- Sulejmani, Rizvan. (2020). *Shqiptaria miti dhe filozofia*. Shkup: Alma.
- Xhaferi, T. (2014). *Implementimi i orientimeve strategjike të Republikës së Maqedonisë në kuadër të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të bashkimit evropian*. Shkup: Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare

---

**ABSTRACT**

---

Political culture represents a complex dimension of the relationship between the individual and the political system, reflecting not only political worldviews and perceptions, but also the ways in which these are translated into action and civic participation. In the context of the Republic of North Macedonia, where the model of governance is built upon the principles of the separation of powers, the partnership between citizens and political leadership emerges as a key element in structuring this culture. However, this relationship is often characterized by a mismatch between those who produce policy and those who are subject to it. Particularly within the Albanian community, political participation and profiling remain less conditioned by classical ideological divisions (left–right) and more by ethnic, social, communal, and religious factors, thereby creating a distinct form of political mentality. This study aims to examine the extent to which the citizen–leadership partnership influences the consolidation of political culture in North Macedonia, by analyzing the levels of Albanians’ involvement in political processes, their perceptions of representation, as well as the role of public opinion as an instrument of a functional democracy. The expected results seek to contribute to a broader understanding of the challenges and opportunities for the development of an inclusive political culture, one that transcends the logic of communal affiliations and moves toward a more democratic model of civic participation.

**Keywords:** *Political culture, citizen–leadership partnership, separation of powers, Albanians in North Macedonia, civic participation, public opinion.*



# BASHKËPUNIMI PARLAMENTAR I MAQEDONISË SË VERIUT ME KOSOVËN DHE ME SHQIPËRINË NË FUNKSION TË FQINJËSISË SË MIRË DHE INTEGRIMIT EVROPIAN

**Jonuz ABDULLAI**

*Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë, Maqedonia e Veriut*

E-mail: j.abdullai@seeu.edu.mk

**Agim SULEJMANI**

*Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë, Maqedonia e Veriut*

E-mail: as20411@seeu.edu.mk

---

## PËRMBLEDHJE<sup>1</sup>

Në këtë punim shkencor hulumtues analizohet bashkëpunimi parlamentar i Maqedonisë së Veriut me Kosovën dhe Shqipërinë në funksion të politikës së fqinjësisë së mirë dhe integrimit evropian. Ndryshimet e mëdhaja gjeopolitike në Europë hedhin një dritë të re në bashkëpunimin parlamentar ndërmjet RMV-së dhe vendeve fqinje të cilat kanë një qëllim të njëjtë strategjik, integrimin e plotë euroatlantik. Pyetja hulumtuese e këtij punimi është nëse bashkëpunimi parlamentar ka impakt pozitiv në fqinjësinë e mirë dhe në procesin e integrimit european të tre vendeve. Parlamentet kanë rol legjislativ dhe kontrollues në procesin e integrimit dhe organet e parlamentit dhe veçanërisht komisionet dhe shërbimet të cilat janë të ngarkuara me çështje të jashtme dhe europeane kanë obligim që në bazë të politikës së përshtatur të zgjerimit dhe fondeve të pregaditura për ate, të përshpejtojnë procesin me target, vitin 2030. Me metodën e analizisës së përmbajtjes të dokumenteve dhe raporteve nga takimet e kuvendeve tërhiqen konkluzione se

---

<sup>1</sup> Ky punim është prezantuar në konferencën ndërkombëtare e ndërdisiplinore “Zhvillimi në kohë të trazura” [Development in Turbulent Times], mbajtur në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, më 14-15 nëntor 2025; Proceedings, fq. 73-74, link: <https://www.sociology.al/sites/default/files/20th%20Annual%20International%20%26%20Interdisciplinary%20Conference%20UNISHKODRA%202025.pdf>

cilat janë temat e këtij bashkëpunimi që jep efekt pozitiv në këtë proces. Organet udhëheqëse, grupet parlamentare të miqësisë si dhe komisionet parlamentare zhvillojnë një bashkëpunim intenziv ndërmjet palëve nëpërmjet të vizitave e takimeve të ndryshme që shërbejnë për ndrim të përvojave të mira dhe për veprime të përbashkëta në shprehjen e interesave të tyre dhe shfytëzimin e përbashkët të fondeve. Për shkak të ngjajshmërive socio-kulturore të tre vendeve ka hapësirë për bashkëpunim në lëminë kulturore e arsimore ku Kuvendet mund të luajnë rolin e urave të afritit të popujve dhe shteteve. Një mundësi tjetër është edhe bashkëpunimi ndërmjet shërbimeve parlamentare të tri palëve që ndihmon në rritjen e aftësive të tyre për realizimin e detyrave të tyre në procesin integruar.

**Fjalë kyçe:** bashkëpunimi parlamentar, Maqedonia e Veriut, Ballkani perëndimor, fqinjësia e mirë, integritimi evropian

Prof. Dr. **Jonuz ABDULLAI** është Profesor ordinar në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i shkencave bashkëkohore sociale, Tetovë dhe Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Bartës i funksioneve të rëndësishme në jetën shoqërore dhe akademike të shqiptarëve në RMV.

**Agim SULEJMANI** është student doktorant në Universitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i shkencave bashkëkohore sociale, programi i Shkencave politike në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. I punësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Departamentin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bursist i Programit për përkrahjen e Kuvendit të RMV-së nga Ambasada e Zvicrës në Shkup.

*Diplomacia parlamentare është mjet i bashkëpunimit ndërkombëtar që u mundëson parlamenteve që njëkohësisht të kryejnë misionin e tyre demokratik brenda shtetit dhe të japin kontributin e tyre për paqën dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare*

## Hyrje

Në prizmin e zhvillimeve gjeopolitike në Evropë pas agresionit rus ndaj Ukrainës në vitin 2022 dhe përshtatjes së politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian ndaj Ballkanit Perëndimor, diplomacia parlamentare në vazhdimësi e rifiton dhe e rikujton rëndësinë e saj në realizimin e interesave strategjike të vendeve të rajonit për integritimin e plotë në Bashkimin Evropian.

Bashkimi Evropian ka miratuar politikën e re të zgjerimit dhe fondin (European Commission, 2023:2) për rritje prej 6 miliardë eurosh me qëllim që ta përshpejtojë procesin e zgjerimit dhe t'u

ndihmojë vendeve kandidate në plotësimin e kushteve dhe anëtarësimin e tyre në BE, në rastin ideal deri në vitin 2030. Tani për tani, (gjendja në gusht 2025) Shqipëria përparon në përmblylljen e grupkapitujve negociues, Maqedonia e Veriut duhet ta kapërcejë procesin e brendshëm të ndryshimeve kushtetuese, ndërsa Kosova ka parashtruar kandidaturën për anëtarësim në Bashkim.

Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë deklaruar nga Bashkimi Evropian si dy pista të cilat e lehtësojnë dhe e përshpejtojnë procesin e integritimit në Bashkim, prandaj edhe nga vendet kandidate kërkohet që të punojnë sinjerisht dhe bashkërisht në këtë drejtim. Parlamentet kanë rol të rëndësishëm dhe të dyanshëm në këtë proces, nga njëra anë funksion legjislativ duke nxjerrë akte ligjore dhe nga ana tjetër funksion kontrollues duke ndjekur zbatimin e ligjeve në praktikë.

Parlamentet luajnë rol të rëndësishëm edhe në përfaqësimin e interesave të vendeve anëtare në arenën ndërkombëtare,

prandaj ato nëpërmjet organeve të tyre zhvillojnë aktivitetet të ngjeshur, si në marrëdhëniet bilaterale ndërmjet vendeve, ashtu edhe në nivelin multilateral në dimensionet parlamentare të organizatave dhe forumeve ndërkombëtare.

Diplomacia parlamentare aktualisht e rrit aktivitetin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare si në formë, ashtu edhe në peshë dhe ajo me specifikat e saj, fleksibilitetin dhe joformalitetin (Bejko, 2023:5) luan rol të rëndësishëm në përparimin e marrëdhënieve bilaterale dhe ndërkombëtare.

Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova janë tri vende fqinje me të kaluar dhe të tashme të ngjashme dhe duke pasur parasysh tiparet e tyre të brendshme politike e sociale dhe qëllimin e tyre të njëjtë strategjik, integrimin në strukturat euro-atlantike, është kërkesë e patjetërsueshme e kohës që këto shtete t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për bashkëpunim në planin bilateral dhe multilateral për ballafaqim me sfidat e tashme dhe për ndërtimin e shtegut drejt një ardhmërie në mirëqenie dhe siguri.

### **Pasqyrë e marrëdhënieve parlamentare të Maqedonisë së Veriut me Kosovën dhe Shqipërinë**

#### *Subjektet e bashkëpunimit parlamentar*

Subjekte të diplomacisë parlamentare janë organet udhëheqëse të kuvendeve si Kryetari dhe grupe të ndryshme parlamentare si Grupet e miqësisë me vendet tjera, Delegacionet në forumet ndërkombëtare, klubet partiake, komisionet për politikë të jashtme, komisionet për çështje evropiane, si dhe komisione e grupe tjera joformale. Këto subjekte zhvillojnë marrëdhënie me subjektet gjegjëse të parlamenteve tjera, si dhe me organe shtetërore të tyre siç janë: kryetarë të shteteve dhe parlamenteve, grupe parlamentare, kryeministra të qeverive,

ministra, persona diplomatikë, por edhe me grupe joqeveritare dhe joformale.

Grupet parlamentare për bashkëpunim dhe delegacionet në organizatat ndërkombëtare formohen me rregullore dhe vendime të brendshme të parlamenteve dhe ato e kanë për detyrë të bashkëpunojnë me organet gjegjëse të parlamenteve dhe organet shtetërore të vendeve tjera.

Aktualisht, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për legjislaturën 2024-2028 ka 51 Grupe për bashkëpunim ndërmjet të cilave edhe Grupin për bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Kosovës të përbërë nga tetë anëtarë (Kuvendi i RMV-së, 2024a).

Për Legjislaturën VII të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesia e Kuvendit në bazë të Vendimit të datës 27.07.2021 emëron kryetar dhe anëtarë të 56 Grupeve të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e vendeve tjera, ndër to edhe me Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas gjendjes në gusht 2025 ka formuar 65 grupe të miqësisë dhe 12 delegacione për përfaqësim në organizata ndërkombëtare parlamentare dhe bashkëpunim me Bashkimin Evropian.

Ky punim do të përqendrohet në bashkëpunimin bilateral ndërmjet kuvendeve të këtyre tri shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor për të përcaktuar bashkëpunimin në funksion të miqësisë së mirë dhe bashkëpunimin rajonal si rrugë lehtësuese për integrimin e të tria vendeve në Bashkimin Evropian.

#### *Bashkëpunimi parlamentar ndërmjet kuvendeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës*

Bashkëpunimi bilateral ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës

viteve të fundit është i shpeshtë dhe përmbajtjesor. Nga analiza e kontakteve ndërmjet dy kuvendeve shihet qartë se çdo vit kemi vizita të ndërsjella të organeve parlamentare, si dhe takime të parlamentarëve me qeveritarë dhe ambasadorë të palës tjetër. Sipas Raportit për mandatin 2020-2024 të Kuvendit të RMV-së gjatë kësaj periudhe ka pasur dy takime bilaterale RMV-RK në Maqedoni ndërsa katër jashtë vendit, gjithsej gjashtë (Kuvendi i RMV-së, 2024b: 148). Është interesante se gjatë kësaj periudhe kryetar i Grupit për bashkëpunim me Kosovën ka qenë deputeti Afrim Gashi, Kryetari i ri i Kuvendit në legjislaturën 2024-2028, fakt që i jep peshë të veçantë bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit të RMV-së dhe atij të Kosovës.

Takimet gjithmonë kanë qenë të singërta dhe diapazoni i bisedimeve i gjerë, si edhe vetë marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve, por dominojnë temat me interes të përbashkët të cilat kanë impakt edhe në bashkëpunimin rajonal dhe integritimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Këtu, së pari bëhet fjalë për intensifikimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit në sferën ekonomike, politike, arsimore, kulturore etj., ku parlamentet kanë funksion të rëndësishëm atë të ratifikimit të marrëveshjeve dhe kontratave ndërkombëtare.

Çështja e dytë është lidhja infrastrukturore ndërmjet të dyja vendeve e cila, jo vetëm që e mundëson lëvizjen më të shpejtë dhe rritjen e shkëmbimit ekonomik bilateral, por ndihmon edhe në ndërlidhjen me vendet tjera të rajonit, gjë që ka impakt pozitiv në bashkëpunimin rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Juglindore. Këtu rëndësi të veçantë ka autostrada Shkup – Bllacë që do ta lidh RMV-në, jo vetëm me Prishtinën, por edhe me Tiranën dhe

Portin e Durrësit e më tutje me Malin e Zi, Kroacinë dhe Evropën. Kjo autostradë është duke u ndërtuar por përballet me pengesa të natyrave të ndryshme, gjë që duhet tejkaluar sa më shpejtë. Një mundësi tjetër ofron edhe rruga rajonale që po planifikohet, e cila do ta lidhte perëndimin e RMV-së me Prizrenin e me këtë edhe me Shqipërinë. Edhe pse ky projekt është i ndërlidhur me shpenzime të larta për shkak të ndërtimit të tunelit, më i rëndësishëm është vullneti dhe transparenca ndërmjet palëve sesa financat e nevojshme. Është për keqardhje që shumë programe dhe fonde evropiane ose mbeten të pashfrytëzuara ose keqpërdoren për shkak të keqmenaxhimit dhe korrupsionit politik.

Çështja e tretë e rëndësishme është shkëmbimi dhe mbështetja e ndërsjellë e të dyja vendeve në rrugën e tyre euro-atlantike. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e NATO-s dhe vend kandidat në fillim të negociatave për integrim në Bashkimin Evropian, ndërsa Republika e Kosovës ka parashtruar kërkesë për anëtarësim në të dy organizatat. Në këtë aspekt, Kuvendi i RMV-së e mbështet anëtarësimin e Kosovës në NATO si garantues i paqes dhe sigurisë në Rajon (Kuvendi i Kosovës, 2023).

*Bashkëpunimi parlamentar ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë*

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë gjithashtu kanë bashkëpunim intensiv dhe përmbajtjesor nëpërmjet vizitave të ndërsjella, takimeve nëpër forume ndërkombëtare dhe takimeve më përfaqësues qeveritarë dhe diplomatikë. Si forma të drejtpërdrejta dhe më efikase preferohen takimet e grupeve parlamentare për miqësi dhe takimet e komisioneve për çështje evropiane dhe ato për politikë të

jashtme. Në të gjithë takimet veçohen marrëdhëniet e mira ndërfaqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal si prioritete të cilat ndihmojnë edhe zhvillimin e brendshëm të vendeve por dhe i përparojnë agjendat e tyre të jashtme që kanë një qëllim të përbashkët, integrimin e plotë euro-atlantik. Këto takime janë bilaterale dhe multilaterale në suaza të forumeve rajonale dhe evropiane siç është p.sh. Konferenca e kryetarëve të komisioneve për çështje evropiane të vendeve kandidatë (KOSAK), pastaj Procesi i Berlinit, Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore, Iniciativa e Evropës Qendrore etj., ku shqyrtohen prioritetet, metodat dhe afatet e bashkëpunimit.

Sa u përket sferave të bashkëpunimit, ekonomia është pikënisja e të gjitha zhvillimeve. Natyrisht që tregtia bashkë me transportin dhe turizmin pas demokratizimit të vendeve kanë rritur nivelin e tyre, por për një zhvillim optimal të tyre nevojitet infrastrukturë më e përparuar e komunikacionit dhe e energjetikës. Korridori VIII si lidhje ndërmjet lindjes dhe perëndimit parasheh ndërtimin e autostradës por edhe hekurudhës që kalojnë nëpërmjet të dy vendeve. Aktualisht punohet në lidhjen ndërmjet dy vendeve nëpërmjet autostradës Tetovë -Gostivar-Kërçovë – Strugë, ndërsa planifikohet edhe hekurudha Kërçovë- kufiri me Shqipërinë si dhe Kriva Pallankë- kufiri me Bullgarinë. Kjo mundëson, jo vetëm lëvizjen më të madhe të njerëzve dhe mallrave ndërmjet vendeve të Rajonit, por në situatë të krizës gjeopolitike ndihmon në zinxhirin global të furnizimit me mallra dhe energji.

Në aspektin e zhvillimit ekonomik-social i nevojshëm është bashkëpunimi për shfrytëzimin e Fondit për rritje ekonomike si dhe bashkëpunimi në projekte për zhvillim ndërkufitar të cilat reflektojnë në të dy anët e kufirit.

Gjatë vizitës së fundit të Kryeparlamentarit Afrim Gashi në Shqipëri në nëntor të vitit 2024 (Kuvendi i RMV-së, 2024c), në takim me kryeparlamentaren Elisa Spiropali është potencuar se integrimi mbetet qëllim i të dyja palëve dhe do të vazhdojë bashkëpunimi në këtë drejtim, pasi politika e zgjerimit është kërkesë gjeostrategjike dhe investim për të gjithë Evropën në aspektin politik, ekonomik dhe të sigurisë. Palët, gjithashtu, dakordohen për bashkëpunim rajonal dhe krijimin e tregut të përbashkët rajonal si urëkalim në tregun evropian. Sa i përket bashkëpunimit parlamentar është shqyrtuar mundësia e bashkëpunimit ndërmjet komisioneve për çështje evropiane dhe këshillave kombëtarë për evrointegritet të të dyja vendeve.

Në takimin e Kryetarit Gashi me Presidentin e Republikës së Shqipërisë Bajram Begaj përveç temave tjera është potencuar bashkëpunimi i të dyja vendeve anëtare të NATO- s në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, që është kërkesë e situatës gjeopolitike dhe rreziqeve të ndryshme që mund të paraqiten në krahun jugor të NATO-s.

Edhe në rastin e marrëdhënieve me Shqipërinë duhet potencuar mundësia e bashkëpunimit edhe në nivelin kulturor dhe ndërmjet shërbimeve parlamentare të të dyja vendeve. Parlamentet moderne janë bërë vende të takimit dhe bashkëpunimit, andaj kultura, arsimit, shkenca, etj., janë mjete shumë të pëlqyera për njoftimin dhe afrimin e popujve dhe vendeve. Kuvendi i RMV-së posedon një nga koleksionet më të mëdha të pikturave në vend dhe një ekspozitë artistike e përbashkët në të dy kuvendet do të ndihmonte në afrimin e popujve dhe parlamenteve.

Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve parlamentare mund të organizohen takime dhe seminare të përbashkëta, pasi edhe sfidat e shërbimeve

parlamentare janë të ngjashme. Procesi i integritimit në Bashkimin Evropian dhe roli i parlamenteve në atë proces është shumë i rëndësishëm dhe specifik dhe shkëmbimi i përvojave dhe mbështetja nga shërbimet e vendeve evropiane është më se i nevojshëm. Një program i tillë për momentin është duke u zhvilluar në nivel të Iniciativës së Evropës qendrore – CEI, ndërsa implementohet nga Parlamenti Italian, që synon nëpërmjet seminareve dhe vizitave t'i mbështes shërbimet parlamentare të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Ukrainës dhe Moldavisë në punën e tyre në rrugën për në Bashkim. Në këtë drejtim duhet përmendur që në Kuvendin e RMV-së punojnë edhe shërbime specifike siç është Instituti parlamentar, Kanali televiziv i kuvendit, Zyra për buxhet etj. Në gjithë këtë vend të veçantë kanë Sektorët për bashkëpunim ndërkombëtar të cilat japin përkrahjen e tyre organizative dhe profesionale. Në Kuvendin e RMV-së, në procesin e diplomacisë dhe bashkëpunimit parlamentar përveç sektorit të lartpërmendur rol të rëndësishëm luajnë edhe Protokollin, shërbimet e komisioneve të jashtme dhe për çështje evropiane, Këshilli Nacional për Evrointegrime etj.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Nga ky shqyrtim i marrëdhënieve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Kuvendet e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë mund të nxjerrim disa përfundime dhe rekomandime, si në vijim:

Marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kuvendit të RMV-së me ato të Shqipërisë dhe Kosovës janë të ngjeshura dhe ato intensifikohen vazhdimisht. Të tria parlamentet në funksionin e tyre legjislativ dhe kontrollues duhen

bashkëpunuar në shkëmbim përvojash të mira ndërmjet tyre dhe në komunikim me organet e Bashkimit Evropian nëpërmjet komisioneve dhe shërbimeve të cilat janë kompetente për marrëdhëniet me jashtë dhe Bashkimin Evropian.

Këto marrëdhënie kanë ndikim pozitiv në politikën e fqinjësisë së mirë të Maqedonisë së Veriut me Kosovën dhe Shqipërinë si vende kandidatë për integritim në Bashkimin Evropian. Në këtë aspekt është i favorshëm bashkëpunimi ndërmjet vendeve në shfrytëzimin e fondeve për zhvillim të BE-së veçanërisht atyre për bashkëpunim kufitar të cilat kanë impakt të shumëfishtë në zhvillimin lokal dhe rajonal.

Integrimi i të tria vendeve në tregun e përbashkët të Ballkanit Perëndimor sjell benefite për të gjithë pjesëmarrësit dhe i afron ato me Bashkimin Evropian. Fondi për rritje prej 6 miliardë eurosh parasheh investime në infrastrukturë dhe energjetikë dhe me këtë vendet forcojnë bazën e vet, ndihmojnë Rajonin dhe Bashkimin në përballimin e sfidave aktuale ekonomike dhe gjeopolitike si dhe sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Në fund konstatojmë që ka nevojë dhe mundësi për plotësimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet kuvendeve dhe ato bashkëpunimin ndërkombëtar duhet ta kuptojnë si një rrjedhë që vazhdimisht sjell gjëra të reja dhe përfitime për të gjitha palët. Një aspekt i bashkëpunimit që mund t'u japë një vlerë të shtuar marrëdhënieve ndërmjet të tria vendeve e me atë të ndihmojë edhe integritimin evropian është sfera e kulturës, e arsimit dhe e shkencës, ku parlamentet nëpërmjet organizimit të seminareve, ekspozitave e koncerteve mund të bëhen ura dhe skena të afrimit të popujve dhe shteteve. Aspekt tjetër është bashkëpunimi i shërbimeve parlamentare të parlamenteve gjegjëse

të cilat vazhdimisht janë në përkrahje të deputetëve me punën e tyre organizative dhe profesionale. Shërbimet parlamentare janë memoria institucionale e parlamenteve

dhe shkëmbimi i ideve dhe praktikave të mira ndërmjet tyre e përparon punën e tyre e me atë edhe procesin integrues në të gjitha vendet e Rajonit.

## REFERENCAT

- Bejko, Lorenca. 2023. "Die parlamentarische Diplomatie und seine Rolle in den internationalen Beziehungen", *SciensaScripts* 2023, Londër.
- European Commission. 2023. "Growth Plan for the Western Balkans", fq.2, 08.11.2023, Bruksel, [https://enlargement.ec.europa.eu/2023-communication-new-growth-plan-western-balkans\\_en](https://enlargement.ec.europa.eu/2023-communication-new-growth-plan-western-balkans_en) (Av. 15 shkurt 2026)
- Kuvendi i Kosovës. 2023. Raporti vjetor i punës 2023, faqe 493, Mars 2023, Prishtinë. [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/12/RaportiVjetoriPunesseKuvenditpervitin2023-Shqip\\_FKBFzSTmrD.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/12/RaportiVjetoriPunesseKuvenditpervitin2023-Shqip_FKBFzSTmrD.pdf)
- Kuvendi i RMV. 2024a. "Vendim për themelimin e grupeve të deputetëve të Kuvendit të RMV-së për bashkëpunim me parlamentet e shteteve tjera", *Gazeta zyrtare e RMV* nr.153, 23 korrik 2024, Shkup, <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/b8e3e3c470454848bae1c24d2e19bb4a.pdf> (Av. 15 shkurt 2026)
- Kuvendi i RMV. 2024b. "Raporti mandator 2020-2024", Shkup; <https://www.sobranie.mk/content/izvestai/СОБРАНИЕ-МАНДАТЕН%20ИЗВЕШТАЈ%202020-2024.pdf> (Av. 15 shkurt 2026)
- Kuvendi i RMV. 2024c. 13.11.2024, Shkup, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-vozvratnata-poseta-na-pretsedatelot-gasina-republika-albanija.nspx> (Av. 15 shkurt 2026)

## ABSTRACT

This scientific research paper analyzes the parliamentary cooperation of North Macedonia with Kosovo and Albania in the function of good neighborly policy and European integration. The major geopolitical changes in Europe shed new light on the parliamentary cooperation between the RMV and neighboring countries that have the same strategic goal, full Euro-Atlantic integration. The research question of this paper is whether parliamentary cooperation has a positive impact on good neighborliness and the European integration process of the three countries. Parliaments have a legislative and control role in the integration process and the parliamentary bodies and especially the committees and services that are in charge of foreign and European affairs have the obligation to accelerate the process with the target year 2030, based on the adapted enlargement policy and the funds prepared for it. By analyzing the content of documents and reports from the meetings of the assemblies, conclusions are drawn on which are the topics of this cooperation that give a positive effect in this process. The leading bodies, parliamentary friendship groups and parliamentary committees develop intensive cooperation between the parties through various visits and meetings that serve to exchange good experiences and for joint actions in expressing their interests and the joint use of funds. Due to the socio-cultural similarities of the three countries, there is room for cooperation in the cultural and educational fields, where the Assemblies can play the role of bridges bringing peoples

and states closer together. Another possibility is cooperation between the parliamentary services of the three parties, which helps to increase their capabilities to carry out their tasks in the integration process.

**Keywords:** *Parliamentary cooperation, North Macedonia, Western Balkans, good neighborliness, European integration*

# MUZIKA SHQIPTARE E DHOMËS MBAS LUFTËS DYTË BOTËRORE DERI NË VITIN 1990

(Trajtesë historike dhe analitike)

Ajet ÇEKIÇI

Universiteti i Arteve, Tiranë

E-mail: a\_cekici@hotmail.com

---

## PËRMBLEDHJE

Ky punim ka për objekt të tij, fazën e dytë të zhvillimit të muzikës së dhomës në Shqipëri, duke synuar pikërisht të hulumtojë proceset e lëvrimit të kësaj muzike me karakter profesionist në vendin tonë pas viteve 1945 deri në fund vitin 1990. Në ndjekjen e procesit sipas metodologjisë historike-analitike, trajtohen autorët më përfaqësues me veprat përkatëse. I pari prej tyre, T. Daija me kuartetin e parë për Harqe (1956). Pas tij, T. Harapi me kuartetin Nr. 1 për Harqe (1963), Limos Dizdari me Trio Nr. 1 për violinë, violonçel dhe piano (1974), Ç. Zadeja me sonatën për violinë dhe piano (1974) dhe E. Ibrahimini me kuartetin për harqe (1989). Nga analiza e kësaj krijimtarije, rezultojnë se: 1) muzika e dhomës zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë muzikore të kohës. 2) përjasja me gjinitë përcaktohet nga kërkesat standarde formale dhe dramaturgjike të tyre; 3) në dallim nga orientimi i përgjithshëm i muzikës shqiptare të kohës drejt formimit si muzikë kombëtare, veprat e muzikës së dhomës shqiptare ruan thelbin tradicionalist, të ushqyer nga estetika romantike e shekullit XIX, nga romantizmi i vonë i fillimshekullit XX si edhe nga autorë rusë të fundshekullit XIX dhe të shekullit XX. Mbi bazën e këtyre modeleve, ajo u përvijua qartë si muzikë kombëtare, me shfrytëzim të gjerë të materialeve muzikore me burim nga folklori apo nga muzika tradicionale popullore.

**Fjalë kyçe:** *muzikantë shqiptarë, muzikë profesioniste, muzikë dhomë, trio, kuartet.*

Ajet ÇEKIÇI është kompozitor shqiptar, i lindur në vitin 1983 në qytetin e Pogradecit. Nga viti 2009 e në vazhdim është asistent lektor dhe titullar i lëndës së Instrumentacion-orkestracionit pranë Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve në Tiranë. Ai është autor i disa artikujve shkencorë të botuar në Shqipëri e Rumani dhe krijimtaria e tij përfshin pothuaj të gjitha gjinitë e muzikës.

## Hyrje

Shqipëria doli prej Luftës II Botërore me një bilanc të Rrënuar ekonomik, me një popullsi me kuota të larta të analfabetizimit dhe të përqendruar në rreth 70% të banorëve në zonat rurale (Duka, 2007: 231). Hapat e rëndësishëm që u ndërmoren gjatë viteve 1920-30 nga shteti shqiptar për rritjen ekonomike dhe emancipimin shoqëror, si edhe zhvillimi i një jete kulturore artistike të panjohur më parë në qytetet kryesore të vendit, ishin, gjithsesi të pamjaftueshme për të tejkaluar prapambetjen e thellë të trashëguar nga periudha e pushtimit të gjatë otoman.

Në aspektin kulturor, gjysma e dytë e shekullit XX për shoqërinë shqiptare shënoi në tërësi një zhvillim përcaktues drejt arsimimit të gjerë të të gjitha shtresave të popullsisë, me ngritjen e sistemit të plotë të edukimit në mbarë vendin, përfshi themelimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës (1957), si edhe institucione të tjera analoge me të, po në Tiranë. Pas shkëputjes nga aleanca me Lindjen komuniste në vendet e të cilave, gjatë viteve 1945-60, u diplomuan me dhjetëra studentë shqiptarë, institucionet e reja të larta arsimore formuan disa breza të specialistëve të të gjitha fushave.

Ashtu si edhe sferat e tjera të jetës shoqërore, letërsia dhe artet në Shqipërinë komuniste njohën zhvillime të alternuara në përkatësi me situatat politike. Që në krye të herës, artet shqiptare iu nënshtruan doktrinës së realizmit socialist, të importuar nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe mbizotëruese në të gjitha vendet e Lindjes komuniste. Por, nëse në këto të fundit, me liberalizimin e sistemit mbas vdekjes së J. V. Stalinit, regjimet u treguan relativisht tolerante për ndërtimin e urave të komunikimit me botën Perëndimore, në Shqipëri, ashpërsimi i luftës së klasave,

e cila arriti kulmet në vitet 1973-1985, absolutizoi kontrollin dhe censurën ndaj institucioneve dhe krijimtarisë artistike. Pjesë e këtij konteksti ekonomik, politik dhe kulturor ishte edhe muzika.

Vitet 1945-90, sipas Prof. Dr. Zana Shuteriqi Prelës (Shuteriqi, 2019: 6), shënojnë periudhën e dytë të zhvillimit të Historisë së Muzikës Shqiptare. Gjatë kësaj kohe muzika shqiptare bëri rrugën e saj, përkatësisht me progreset, statuskuotë, dogmatizmin dhe politizimin. Në këtë terren, periudha e zhvillimeve muzikore të pas Luftës II Botërore shënoi ndarjen përfundimtare nga gjysmë profesionalizmi i mëparshëm dhe përcaktimin e vet si muzikë profesioniste. Për këtë ndikuan shumë faktorë, disa ndër më kryesorët do të ishin: 1) formimi i brezit të parë të kompozitorëve profesionistë në konservatoret e vendeve të Lindjes (kryesisht në ish BS), si Çesk Zadeja (1927-1997), Tish Daija (1926-2003), Tonin Harapi (1928-1992), Nikolla Zoraqi (1929-1991), Kozma Lara (1930-2019), Pjetër Gaci (1931-1995) etj., të cilët, në fund të viteve '50, u përfshinë në jetën muzikore dhe në institucionet kryesore artistike të vendit (krahas disa kompozitorëve që e kishin nisur veprimtarinë përpara ose gjatë viteve të luftës si Kono dhe Jakova, apo të emrave të tjerë që u bënë të njohur në vitet 1945-1955); 2) krijimi i sistemit të edukimit muzikor profesional me hapjen, më 1946, të shkollës së mesme artistike "Jordan Misja" në Tiranë dhe, më 1962, të Konservatorit Shtetëror të Tiranës (Frashëri, 2008: 229) dhe 3) themelimi i institucioneve artistike, të paraprirë nga Filharmonia e Shtetit më 1950, më pas Teatri i Operës dhe Baletit (1953), Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve (1957), Orkestra Simfonike e RTSH (1962) etj.

Në varësi të zhvillimeve të përgjithshme artistike në vend, gjatë periudhës 1945-1990 muzika shqiptare njohu dy faza zhvillimi: e para, që shtrihet prej vitet 1945 e deri rreth fundit të viteve '60, ndërsa e dyta përmbledh rreth dy dekadat e viteve 1970-90. Në vështrim të përgjithshëm, nga njëra fazë në tjetrën muzika shqiptare përshkoi rrugën e rritjes profesionale, të kalimit nga tradicionalizmi i ngurtë drejt kërkimit të hapësirave më të shpenguara krijuese. Në fillim të viteve '70, brezi i parë i kompozitorëve të pas Luftës kishin arritur pjekurinë e tyre krijuese, ndërkohë që në skenën muzikore shfaqet një brez i dytë kompozitorësh, të formuar në KSHT (më vonë ILA), si Feim Ibrahim (1935-1997), Limos Dizdari (1942), Shpëtim Kushta (1946), Kujtim Laro (1947-2004), Thoma Gaqi (1948), Aleksandër Peçi (1951), më pas Haig Zaharian (1952), Sokol Shupo (1954), Thoma Simaku (1958) etj. Janë përgjithësisht këto emra që, krahas kompozitorëve të brezit paraardhës, mbizotëruan në zhvillimin e krijimtarisë muzikore të viteve 1970-1990.

Tjetër faktor i rëndësishëm ndikues i rritjes së krijimtarisë muzikore shqiptare të atyre viteve ishte, padyshim, zhvillimi i ndjeshëm i veprimtarisë koncertale në Tiranë, por edhe më gjerë. Themelimi i Koncerteve të Majit në vitin 1967, më pas edhe i formave të tjera të aktivitetit artistik muzikor (Festivali i romancës, konkurse të ndryshme instrumentale, vokale, të formacioneve orkestrale etj.), luajtën rol të drejtpërdrejtë nxitës për krijimtari të re. Ky faktor bëhej edhe më përcaktues në kushtet e izolimit të thellë, që kaloi shoqëria shqiptare pas prishjes së marrëdhënieve me RPK dhe pas Plenumit IV të KQPPSH, që në emër të “artit kombëtar” dhe “popullor” i shpalli luftë të paprincipitë çdo lloj ndikimi të mundshëm

prej botës perëndimore. Censura dhe kontrolli politik mbi repertorin artistik, po ashtu si edhe për krijimtarinë, mbyllën shtigjet e pasurimit të repertorit me vepra të autorëve të huaj duke u përqendruar më së shumti në muzikën kombëtare.

Përgjithësisht, në këtë periudhë të dytë të zhvillimit të saj (1945-1990), me përjashtim të rasteve të pakta (p. sh. dy koncertet për piano dhe koncerti për oboe të F. Ibrahimit, Koncerti Nr.1 për piano e A. Peçit e ndonjë tjetër), krijimtaria muzikore shqiptare ruan thelbin tradicionalist, të ushqyer nga estetika romantike e shekullit XIX, nga romantizmi i vonë i fillimshekullit XX si edhe nga autorë rusë të fundshekullit XIX dhe të shekullit XX (Prokofiev, Shostakoviç, Haçaturian). Mbi bazën e këtyre modeleve, ajo u përvijua qartë si muzikë kombëtare, me shfrytëzim të gjerë të materialeve muzikore me burim nga folklori apo nga muzika tradicionale popullore.

Muzika shqiptare e dhomës e gjysmës II të shekullit XX kaloi të njëjtat procese sa më sipër dhe reflektoi veçoritë e parashtruara të artit muzikor shqiptar të kohës. Në të vërtetë, veprat e shkruara gjatë kësaj periudhe për formacionet dhe gjinitë standarde të dhomës janë relativisht të pakta në numër dhe, me pak përjashtime, me arritje modeste profesionale. Arsyet për këtë kanë të bëjnë sa me faktin që, për specifikën e vet, muzika e dhomës nuk mund t'i përgjigjej sa edhe si duhet kërkesave të doktrinës, po aq edhe me ngurrimin e kompozitorëve për t'iu qasur gjinive të llojit. Gjithsesi, nga veprat që janë trajtuar më poshtë, dëshmohet se muzika e dhomës në Shqipëri u zhvillua në të njëjtat etapa dhe reflektoi pak a shumë të njëjtat karakteristika si edhe pjesa tjetër e muzikës shqiptare të viteve 1945-1990.

## Muzika shqiptare e dhomës në vitet 1945 - 1990

Vepra e parë që i përgjigjet kërkesave të gjinisë me standarde të formës e strukturës kompozicionale, është Kuarteti për harqe i Tish Daisë (Leotsakos, 2001: 841), i kompozuar në vitin 1956, kur autori ishte ende në proces të studimeve për kompozicion në Konservatorin “P. I. Çajkovski të Moskës”. Kuarteti ruan konceptin tradicional të ciklit katërkohësh, ku çdo njëra prej të cilave i përmbahet formave dhe kërkesave të gjinisë. Në tërësinë e strukturës kompozicionale, autori është mbështetur në folklorin muzikor të Veriut. Por, jo rastësisht në shtypin e kohës ndeshen dhe kritika në lidhje me mungesën e citimeve konkrete të materialeve burimore (Krantja, 1954: 87-93). Duke lënë mënjanë qëndrimet dogmatike mbi marrëdhënien me folklorin, Kuarteti i Daisë, me përpjekjen e qartë për t’iu larguar stilizimeve të thjeshta të materialeve popullore, siç paraqiten disa nga veprat e para orkestrale të viteve 1940-43, por edhe sikundër propogandohej nga shtypi i kohës, shënon një hap përpara në zhvillimet e muzikës instrumentale shqiptare.

I ndërtuar sipas standardit tradicional ciklik - koha e parë Allegro sonatë me kodë, koha e dyta e ngadalhtë tripjesësh i thjeshtë, koha e tretë një skerco me trio, dhe koha e katërt rondo – vepra e Dajisë përfaqëson rastin e parë në muzikën instrumentale shqiptare, përfshi edhe atë të dhomës, në të cilën respektohen dhe zbatohen normat e gjinive të mëdha ciklike. Përdorimi i formave muzikore si sonata, tripjesëshi apo rondo, tregon qartë se Kuarteti ndërtohet mbi kriteret tipike dramaturgjike të muzikës së llojit duke krijuar kështu bindjen e plotë të një vepre përfaqësuese në gjininë përkatëse.

T. Daija është praktikisht i pari autor shqiptar, që përdor me mjeshtëri në ansamblin instrumental të dhomës elemente të caktuara burimorë të gjinive të këngës (Sokoli, 1965) apo valles tradicionale, duke iu larguar stilizimit të thjeshtë apo citimeve. Këtë ai e arrin përmes përdorimit të teknikave adekuate kompozicionale, kryesisht imitacioneve motivike. Gjuha harmonike e përdorur në vepër, ndonëse tradicionale, paraqitet e pasur përmes sekuencave tonale-moduluse, tingujve kalues, kromatikë, vonesave, përshpejttimeve, etj, si edhe shfrytëzimit me mjeshtëri në të katër kohët të tingullit

### Shembulli muzikor 1: *Tish Daija, Kuarteti Nr. 1, koha e I, Allegro, m. 17-27*

The image shows a musical score for the first movement of Tish Daija's Quartet No. 1, measures 17-27. The score is in 3/4 time and features a treble and bass clef. The tempo is marked 'Allegro'. The music consists of a melodic line in the upper voice and a more rhythmic, accompanimental line in the lower voice.

pedal të njëfishtë apo të dyfishtë, që në vendosjet harmonike vertikale prodhon edhe harmoninë polimodale. Kuarteti për harqe është regjistruar në vitin 1982 në Radio Televizionin Shqiptar (Arkivi-RTSH, 1982).

Shtatë vite më vonë (1963), Tonin Harapi (Shupo, 2002: 102) kompozoi kuartetin e tij të parë për harqe, të ndjekur nga tre të tjerë në vitet e mëvonshme, përkatësisht më 1981, 1986 dhe 1987. Pavarësisht se midis autorëve të tjerë të kohës Harapi demonstroi më shumë interes ndaj muzikës së dhomës, kjo nuk mbetet fusha më përfaqësuese e krijimtarisë së tij. Ai shkroi në të gjitha gjinitë e muzikës, me përjashtim të baletit. Por profili i tij krijues shfaqet më mirë se kudo në gjinitë e vogla, romancat dhe pjesët për piano. Veçoritë e tyre si ndjeshmëria poetike e melodive dhe shfrytëzimi gjerësisht i materialeve të folklorit muzikor apo këngës popullore qytetare, përshkojnë gjithë krijimtarinë e autorit, përfshi edhe muzikën e dhomës.

Kuarteti i harqeve Nr.1 i Harapit, po ashtu si edhe ai i Dajisë, është vepër me koncept të qartë ciklik prej katër kohësh dhe i shkruar besnikërisht sipas traditës klasike të gjinisë. Në këtë pikëpamje, po aq sa edhe mbështetja në traditën burimore folklorike apo ndërtimi i materialeve melo-harmonike mbi bazë modale, vepra shfaq karakteristika të ngjashme me atë të Dajisë. Në kuadrin e ciklit tradicional, gjuha muzikore paraqitet relativisht e zhvilluar dhe vepra *shënon evolucion të dukshëm në drejtim të zhvillimit të momentit krijues e të forcimit të përmbajtjes ideore e artistike të ansambllit* (ILA, 1989: 368). *Në vitet në vazhdim, deri aty rreth fundit të viteve '80, Harapi do t'i drejtohej rregullisht muzikës për ansambël instrumental, duke shkruar, krahas tre kuarteteve të tjerë edhe tre trio për violinë, violonçel dhe piano*

përkatësisht më 1984, 1986 dhe 1988. Pavarësisht ndryshimeve që ndeshen mes tyre, kuartetet e Harapit ruajnë shumë karakteristika të përbashkëta, tipike për stilin e kompozitorit në përgjithësi: qartësinë e strukturës klasike, natyrën përgjithësisht vokale të materialeve muzikore (temat), mbështetjen e përherëshme në traditën burimore të këngëve dhe valleve me përdorime të citimeve të plota apo të pjesshme të materialeve të origjinës. Por ndonëse kuartetet u shkruan në një hark relativisht të gjatë kohor, duhet thënë se koncepti kompozicional dhe gjuha muzikore e tyre mbetet përgjithësisht e njëjtë, pa shënuar ndonjë progres nga njëra vepër në tjetrën. Në këtë kontekst, mund të thuhet me bindje se tre kuartetet e fundit të Harapit paraqiten si vepra të një cikli të vetëm, të ngjashme në formë, në strukturë dhe ide kompozicionale me kuartetin nr. 1. Por nëse ky i fundit paraqet interes për kohën kur u krijua, në kompozimet e mëpasme të llojit autori do të shfaqte gjithnjë e në mënyrë më të ndjeshme prirjen drejt thjeshtëzimit të gjuhës muzikore dhe të koncepteve kompozicionale bazë të muzikës së dhomës. Për këto arsye, kuartetet nr. 2, 3 dhe 4 apo trio nr. 1, 2 dhe 3 më shumë se përcaktimet gjinore (trio, kuartet) që mbajnë, mund të konsiderohen si “pjesë” për kuartet harqesh apo për trio.

Siç u përmend më sipër, me fillimin e viteve '70 muzika shqiptare hyri në një fazë të re, gjatë së cilës shfaqen dy prirje kryesore, e para ndër të cilat pothuajse gjithëpërfshirëse, ndërsa e dyta me një përfaqësim shumë më të pakët, por me interes për sa i takon zhvillimeve të reja që do të ndodhnin pas viteve '90. Konkretisht, gjatë këtyre dy dekadave muzika në Shqipëri fitoi në drejtim të pjekurisë krijuese (brenda formatit tradicional), të shfaqur në disa drejtime:

në spikatjen e individualiteteve krijuese, pasurimin e gjuhës muzikore, tejkalimin e standardeve normative drejt një qasjeje më të lirë kompozicionale. E gjithë kjo ndodhi kryesisht mbi bazën e konceptit të muzikës kombëtare. Ndërkohë, në vepra të veçanta të disa kompozitorëve më të rinj (brezi i dytë), që prej fillimit të viteve '70 dhe në dhjetëvjeçarin në vazhdim, shfaqen prirje drejt eksperimentimit me teknikat muzikore të shekullit XX, kryesisht ato neoklasike dhe, në mënyrë më të kamuflluar ose spontane, edhe ekspresioniste. Këto zhvillime, edhe pse nën shënjestrën e kritikës dhe censurës ideologjike, përvijuan për herë të parë në muzikën shqiptare qëndrimet antiromantike dhe antitradicionaliste, që do të përcaktonin procesin e tranzicionit drejt themelimit të muzikës moderne shqiptare në fillimet e viteve '90.

Në kontekstin e përshkruar, muzika e dhomës bëri rrugën e vet, si edhe më parë e kufizuar në sasi, por, së paku me një apo dy arritje ndër kryesoret të muzikës shqiptare në tërësi. Nga fondi relativisht i vogël i veprave të shkruara mes viteve 1970-90 këtu janë tërhequr tre prej tyre, si shembuj përfaqësues të prirjeve të parashtruara: Trio nr. 1 për violinë, violonçel dhe piano, *Këngët e tokës* e Limos Dizdarit, Sonata për Violinë dhe Piano e Çesk Zadesë, dhe Kuarteti i Harqeve i Feim Ibrahimit.

Deri në vitin 1974 kur shkroi Trion nr. 1 *Këngët e tokës*, Limos Dizdari (Shupo, 2002: 63) ishte bërë i njohur si autor i muzikës së filmave, gjithashtu edhe i disa romancave e këngëve të suksesshme. Pas mirëpritjes nga publiku të trios së parë në Koncertet e Majit të vitit 1974 (luajtur nga I. Madhi, M. Denizi dhe A. Tartari), ai shkroi edhe tre trio të tjera për të njëjtin formacion. Të gjitha së bashku ato u përfshinë në një cikël, që mban titullin e trios së parë; ato ruajnë

lidhje të drejtpërdrejta me dy fushat e krijimtarisë së autorit si në drejtim të karakterit muzikor, ashtu edhe për sa u takon materialeve muzikore, kryesisht me bazë kënge.

Trio nr.1, për violinë, violonçel dhe piano përmban dy kohë dhe, në mënyrën e saj, reflekton atë lloj qëndrimi më të çliruar ndaj normave tradicionale, që karakterizon muzikën shqiptare të pas viteve '70. Duke mos iu përmbajtur kritereve standarde të gjinisë, trio paraqitet më shumë si një suitë dykohëshe, koha e dytë e së cilës fiton peshë si një lloj rondo-sonate (ILA, 1985: 367). Të njëjtin koncept kanë dhe triot e tjera të ciklit: ndërtime të lira të tipit suitë, me mbizotërim të melodizmit të tipit vokal, të lidhur në mënyrë të ndërsjelltë me muzikën e filmit dhe me romancat e autorit. Në kohën kur u shkruan, triot e Dizdarit tërhoqën vëmendjen e publikut, i cili gjente në to lirizmin e ndjeshëm dhe spontan, përtej toneve patetike, mbizotëruese në pjesën më të madhe të krijimtarisë së viteve që pasuan Plenumin IV të KQPPSH.

Në muzikën instrumentale shqiptare në përgjithësi, përfshi këtu edhe muzikën e dhomës, viti 1974 shënon një arritje domethënëse, kompozimin nga Çesk Zadeja (Leotsakos, 2001: 714) të **Sonatës për Violinë dhe Piano**. Zadeja nisi të afirmohet si një ndër penat e rëndësishme të muzikës shqiptare që prej viteve të studimit në Konservatorin "P. I. Çajkovski" të Moskës, kur shkroi, si bashkautor me kompozitorin Rus Jurij Svirodov (Tole, 2022: 156-57), muzikën e filmit *Skënderbeu* (1953). Tre vite më vonë, më 1956 mbrojti diplomën me Simfoninë në La minor, e cila ka hyrë në historinë e muzikës si simfonia e parë shqiptare. Në kopertinën e partiturës, autori e cilëson veprën "Sinfonia nr. 1". Por meqenëse Zadeja nuk shkroi sinfoni

**Shembulli muzikor 2:** Çesk Zadeja, *Sonata për violinë dhe piano, koha I, Moderato, m. 1-8, transkriptimi për violë e piano nga violisti Gjergj Pekmezi*

- KOHA I<sup>ma</sup> -

1

të tjera veç së parës, na duket më me vend cilësimi sipas tonalitetit (La minor). Me kalimin e viteve, si përfaqësues i brezit të parë të kompozitorëve të pas Luftës, Zadeja u bë një ndër figurat qendrore të artit muzikor në Shqipëri. Në fushën e muzikës instrumentale, ai shkroi një sërë pjesësh pianistike, të cilat, së bashku me vepra më madhore (si Sinfonia, baleti *Delina*, Koncerti për piano dhe orkestër) dëshmuuan këmbënguljen e tij për përpunimin e një gjuhe origjinale me bazë kombëtare. Sonata për violinë e piano e vitit 1974 shënon arritjen e tij më të rëndësishme në këtë drejtim dhe, njëkohësisht, një ndër realizimet më të mira muzikore të kohës. Sipas Shuteriqit, sonata e Zadesë, me përmbajtjen e saj të re, shënon një rrugë të re krijimi në muzikën tonë, të përgjithësimin të tij nëpërmjet tipareve shoqërore të lidhura

me temperamentin. Në krijimtarinë e vetë Zadesë, kjo tendencë nuk mund të thuhet e re (Shuteriqi, 1976: 148).

Çështje e vërteta, me racionalitetin e gjuhës muzikore dhe çlirimin prej çdo lloj patetizmi, Sonata e Zadesë fillimisht u prit me një lloj skepticizmi të ushqyer nga fryma e përgjithshme e muzikës shqiptare të kohës, ku gjendjet më të thelluara meditative, tipike për muzikën e dhomës, pothuajse ishin krejtësisht të munguara. Me kalimin e viteve, vepra mori vlerësimin e duhur duke u përfshirë gjithnjë e më shumë në repertorin shqiptar të violinës, nga instrumentistë brenda dhe jashtë vendit. Sonata gjithashtu njih transkriptime edhe për dy instrumente të tjerë me hark, për violë nga violisti Gjergj Pekmezi në vitin 1976, dhe për violonçel nga çelisti Gjergj Antoniu në vitin 1983 (Dema, 2010: 224).

**Shembulli muzikor 3:** *Česk Zadeja, Sonata për violonçel dhe piano, koha I, Moderato, m. 1-8, transkriptimi për violonçel dhe piano nga çelisti Gjergj Antoniu*



Sonata është e kompozuar në dy kohë, e para ndër të cilat paraqitet si një prelud për të dytën. Ndonëse e shkurtër dhe e ndërtuar thjesht, koha e parë mban peshën e gjithë veprës jo vetëm për mendimi të përqendruar, meditativ muzikor, por sidomos për mjeshtërinë e gjuhës muzikore. Nisur nga ky vlerësim, shtjellimi analitik i kësaj kohe do të jetë paksa më i detajuar.

Koha e parë ka ndërtim të thjeshtë monomotivik (A-B-A1) (Chaplin, 2013: 195), pasi i gjithë mendimi muzikor buron prej seksionit të parë A, të ndërtuar me tre periudha të strukturuar si një tripjesësh brenda seksionit (A). Fjalja e dytë është modale kromatike, e ndërtuar në bitoninë e tingujve të pentatonit të parë si pedal harmonik, por statike në figuracionin ritmik të instrumentit të violinës, me ndryshim të tempit që përfundon me notën

e parë të pentatonit *Do*. Pra, këtu kemi të bëjmë me një kontrast të rrjedhshëm; gjymtyrët e periudhës më tepër plotësojnë se sa i kundërvihen njëra-tjetrës.

Midisi zhvillues përmban katër periudha: e para (fillon në piano solo) me dy fjali modale kromatike dhe mbi boshtin e notës *Sol*, ndërsa e dyta në boshtin *Do*. Periudha e dytë mbivendoset në të dy boshtet e periudhës së parë dhe të jep përshtypjen e një gjendjeje dominante të paqëndrueshme harmonike-modale. Periudha e tretë, njëkohësisht edhe kulminacioni i midisit, pasi sjell kontrastin në lartësi, paraqitet si një reprizë intonative e mbivendosur me tingujt e pentatonit të periudhës së parë të (A) dhe harmonisë modale, por pa ndryshuar strukturën ritmike. Periudha e fundit e midisit (solo në instrumentin e pianos), paraqitet si një reprizë e periudhës së

**Shembulli muzikor 4:** *Česk Zadeja, Sonata për violinë dhe piano, koha I, Moderato, m. 1-11*

Moderato

parë të (B), e ndërtuar në intonacionin e pentatonit të dytë me bazë në *Mi* dhe në tingëllim krijon përshtypjen e një predikti të paqëndrueshëm dominantash për tingullin e dytë të pentatonit të parë, notën *Re*, që deri më tani nuk është përdorur si bosht harmonik.

Repriza përmban dy periudha të vetme. E para prej tyre, me karakteristikën e një reprize të rreme, është modale, përmban një solo në instrumentin e violinës me intonacion të tingëllimit të një dominante të notave të bitonisë pentatonike të pentatonit të parë (re-la), dhe ka një frazë mbyllëse pedal të këtyre tingujve të bitonisë, që krijojnë idenë intonative të marrëdhënies (D-T). Në periudhën e dytë, reprizë statike, fjalia e parë dhe e dytë janë në dialog melo-ritmik me instrumentin e pianos, dhe fraza mbyllëse është në një pedal në tingullin e

pestë të pentatonit të parë në notën *La* në instrumentin e violinës, në dialog me lëvizje harmonike-modale në instrumentin e pianos dhe kadencon e transportuar në pentatonin e parë me bazën notën *La*.

Nga gjithë sa u përshkrua, duket se koha e parë e sonatës së Zadesë, përkundrejt një strukture relativisht simetrike, përmban një gjuhë harmonike tejet të elaburuar. Autori operon me mbivendosje të modeve pentatonike (kryesisht bimodale), duke gërshetuar me mjeshtëri diatonikën me kromatikën. Harmonia kështu fiton rol parësor përkundrejt melodisë dhe ritmit. Ndërthurja e hallkave të gruptingujve modalë, transporti dhe mbivendosja e tyre e fragmentarizojnë linjën melodike duke i dhënë një shprehje recitative, të përforcuar nga lineariteti i fakturës muzikore.

Ashtu si edhe koha e parë, e dyta, në karakterin e një lloj skercoje, përshkohet e

gjitha nga ndërthurjet harmonike modale, të cilat prodhojnë edhe këtu dualitetin interesant diatonikë-kromatikë. Siç mund të kuptohet, unifikimi tërësor i veprës nuk ndodh si rëndom në muzikën tradicionale përmes përbërësve motivikë ose tematikë, por me anë të ndërlidhjeve të brendshme harmonike.

Koha e dytë ka formë sonatë me hyrje dhe kodë. Në hyrje përdoret harmoni pentatonike, ndërsa në vazhdim modalo-diatonike. Struktura e temës së parë (A-B-C-C1) përmban elementet strukturore lidhëse dhe mbyllëse. Hyrja fillon në një pedal të bitonisë së notave re-la, të ndeshur gjithashtu në reprizën e rreme të kohës së parë. Lëvizja melodike diagonale krijon pentatonin në një tetratoni me qendër në tingullin e katërt *Sol* dhe mbyllet në pentatonin e plotë të tingullit të dytë *Re*. Tema e parë vazhdon e mbivendosur po në këtë bosht bitonik, që bën lidhjen logjike modalo-harmonike dhe ruan koherencën intonative midis të dyjave kohëve. Boshti pedal i bitonisë në instrumentin e pianos është si një plan tonal i mbivendosur në harmoninë (T-D), por që në planin dominantë shfaqet qartë mungesa e intervalit të tercës mazhore; është pikërisht kjo mungesë, që përcakton qartësisht ndërtimin harmoniko-modal. Sonata për violinë dhe piano është regjistruar në vitin 1986 në Radio Televizionin Shqiptar nga instrumentistët violinë Rajmonda Koço, piano Nora Çashku.

Një ndër veprat e fundit të muzikës instrumentale të viteve '80, gjithashtu e fundit në krijimtarinë e kësaj periudhe të autorit, është Kuartet për harqe nr. 1 (1965-1989) i Feim Ibrahimit (Leotsakos, 2001: 47). I kompozuar në vitin 1965 si veprë studentore dhe i ripunuar më 1989, kuarteti i Ibrahimit shfaq dukshëm prirjen e autorit drejt largimi prej koncepteve tradicionale klasiko-romantike. Në

muzikën e Ibrahimit kjo përjasje e re përbën një vazhdimësi të qëndrueshme krijuese të shpalosur gjatë viteve 1970-80, duke nisur nga Koncerti Nr. 1 për piano të vitit 1971, (*Gazeta Drita*, 1971: 2) dhe e vijuar më pas, së paku, me Koncertin Nr. 2 për Piano, 1975 (Ibrahimi, 2023: 68-69), me Koncertin për Oboe dhe Orkestër (1982) dhe baletin *Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë* (1986). Veçanërisht me dy koncertet për piano Ibrahimi u përcaktua si kompozitor me synime të qarta novatore, për afrimin e muzikës shqiptare me rrjedhat muzikore evropiane të gjysmë së parë të shek. XX, duke iu referuar teknikës melodike-harmonike të disa prej autorëve të kohës si Prokofiev, Bartok dhe Stravinski. Te koncertet shfaqet dukshëm largimi prej funksionalitetit të sistemit mazhor-minor, mbizotërues në krijimtarinë e autorëve shqiptarë të asaj periudhe. Në këtë rast bëhet fjalë për përdorimin e harmonisë me kuarta dhe kuinta dhe harmonisë me sekunda, por gjithnjë brenda konceptit formal tradicional (ashtu si dhe te Sonata e Zadesë). Në këtë pikëpamje, por edhe në drejtim të strukturës harmonike, F. Ibrahimi duket se mbështetet te modeli i veprave ciklike (kuartetet, koncertet për orkestër) të Bartokut.

Edhe pse i takon periudhës së fundit të muzikës shqiptare të realizimit socialist, vepra e ripunuar i përmbahet stilistikisht karakteristikave që lidhen me autorët e përmendur. Kuarteti ka një gjuhë muzikore në thelb me strukturë tonale, por duke shfaqur njëkohësisht elemente të muzikës atonale dhe të serializmit me transpozicion të kufizuar (*modi i transportuar jo i plotë*).

Gjuha muzikore e kuartetit është mjaft e përparuar për kohën, për të përmendur paraprakisht ndërtimin intervalor mbizotërues kuartë-kuintë/sekondë dhe shmangia e intervalit të tercës, veçori që e largojnë së tepërmi nga sistemi

harmonik funksional. Nisur nga të gjitha këto, duhet thënë se Kuarteti për Harqe i Ibrahimit shënon pikën më të përparuar të zhvillimit të muzikës shqiptare të dhomës, por jo vetëm, deri në fund të viteve 1980.

Materiali i kohës së parë dhe shtjellimi i tij paraqitet krejtësisht larg ndërtimeve të melodive të këndueshme apo citimeve konkrete të folklorit muzikor si kuartetet e autorëve paraardhës. Tema kryesore fillon në violinën e parë në modin jonian të transportuar në *Fa*, e vendosur vertikalisht në instrumentet e tjera në modin miksolidian, i transportuar përsëri në *Fa*, prej nga krijohet në analogji profili i një qendre graviteti tonike. “Modi është një nga armët e forta të Ibrahimit. E gjithë puna e tij përshkohet nga një tendencë e synuar si në modalitetin pentatonik ashtu edhe në atë kromatik” (Buharaja, 2013: 2).

Tema ndërtohet mbi strukturën bazike me katër intervale: septima minore, kuartë-kuintë e pastër dhe sekondë maxhore. Këto intervale janë përbërësit kryesorë meloritmikë të motivit me ndërtim gjenerues në katër përsëritjet e temës së parë, e fundit ndër të cilat e mbivendosur me figuracionin ritmik të partit lidhës.

Në ndryshim nga koncepti tradicional i ekspozicionit të formës sonatë, autori këtu e sjell temën në mënyrë përsëritëse, të dinamizuar në zvogëlim-zmadhim të vlerave ritmike, me strukturën motivike të vendosur në invers dhe retrograd. Këto

zhvillime teknike përcaktojnë kontrastin e brendshëm të temës. Parti lidhës ruan të njëjtën strukturë intervale, ku në disa momente figura ritmike e zvogëluar merr rol zhvillues për temën kryesore. Tema e dytë (sekondare) fillon në modin eolian dhe është e ndërtuar me elementët intervalorë motivikë si bulëzat e motivit të parë në retrograd, duke ruajtur intervalet kryesore të vendosur në një figurë ritmike të pikëzuar dhe vertikalisht me triolën katërshe. Ndryshim sjell në këtë rast rimarrja dhe vendosja në dialog e temës kryesore të transportuar një kuartë lart, që merr rolin e një midisi kontrastues për temën e dytë. Parti mbyllës ka elemente melo-motivike nga struktura ritmike e temës kryesore të vendosura në imitacione dhe sekuenca diatonike.

Përpunimi është i ndarë me dy seksione; i pari fillon me vendosjen vertikale të të dy temave, por tashmë me përdorim të ritmikës së sinkopuar, e paparashtruar kjo në ekspozicion. Pikërisht ky element i ri ritmik përcakton rritjen e kontrastit me fillimin e përpunimit. Seksioni i dytë risjell në dialog temat e vendosura në lartësi të ndryshme, ku ndërthuren ritmika e triolës së temës së dytë me ritmikën melo-motivike të temës së parë; kjo e fundit është statike në ritmikë, por e transportuar dhe e sekuencuar në lartësi të ndryshme. Repriza ndërtohet njëjloj si përpunimi, me dy seksione të

**Shembulli muzikor 5:** *Feim Ibrahimit, Kuartet për harqe, motivi i temës kryesore dhe temës sekondare të kohës së parë*

**Shembulli muzikor 6:** *Feim Ibrahimi, Kuarteti për harqe, tema kryesore koha e parë, Allegro moderato, m. 1-5*

*Allegro moderato*

ndara. Seksioni i parë rikthen temën kryesore në gjendje statike, me të njëjtën strukturë dhe fizionomi si në ekspozicion, ndërsa seksioni i dytë është kontrastues, pasi tema e dytë është e vendosur në dublime dhe lartësi të ndryshme, me ritmikën gjashtëmbëdhjetëshe të partit lidhës dhe me intervalet meloritmike të temës kryesore. Zhvillimi që ndodh në këtë seksion sjell si rezultat kodën, e cila, e mbështetur siç paraqitet në vlerat ritmike të të dy temave të varjuara dhe në intervalet melo-ritmike të ekspozicionit, merr rolin e reprizës intonative.

Koha e parë e kuartetit, ashtu si edhe dy kohët e tjera, tregon se me këtë vepër Ibrahimi hedh një hap të rëndësishëm drejt muzikës së konceptit strukturor. Për të siguruar intensitetin dramatik, autori në parim nuk e shpërbën konceptin tematik dhe standardin formal tradicional (koha I formë sonate, koha II tripjesësh i përbërë me episod dhe kodë të vogël, koha III është e konceptuar në formën rondo sonatë, por me strukturë më të gjerë prej gjashtë seksionesh: (A-B-A1-C-B1-A2-kodë). Por brenda

këtyre kornizave, muzika i nënshtrohet përpunimit të dendur faktoror, ku celulat intervalore motivike (me burim tematik) dhe figuracionet ritmike të materialeve përbërëse ndërthuren mes tyre për të gjeneruar tërësinë logjike.

## Përfundime

Në një vlerësim përfundimtar mbi muzikën shqiptare të dhomës së gjysmës II të shekullit XX, mund të pohohet se, që prej vitit 1956, kur Tish Daija kompozoi kuartetin e tij të harqeve, ajo hyri përfundimisht në procesin e konsolidimit të profesionalizmit. Qasjet drejt këtij të fundit ecin paralelisht me ato të muzikës shqiptare në tërësi, sipas fazave përkatëse. Viti 1956, krahas kuartetit të Dajisë, shënon edhe datën e krijimit të simfonisë së parë shqiptare, të kompozuar nga Çesk Zadeja. Në të dy rastet, krahasimet përkatëse me autorët paraardhës të periudhës së parë paraprofesioniste (1910-1940) do të ishin efikase. Në ndryshim nga Lec Kurti, që në duot, triot dhe kuartetet më shumë se

sa në specifikat kompozicionale të gjinive përqendrohet te loja në ansambël (duo, trio, kuartet) dhe shkrimi instrumental, Tish Daija në kuartetin e tij i bashkërendon këto dy kërkesa për t'iu përgjigjur veçorive të gjinisë. I njëjti krahasim është i vlefshëm midis simfonisë së At Martin Gjokës *Dy lule mbi vorr të Skanderbegut* (1919) dhe Simfonisë në La minor të Zadesë. Me pak fjalë vitet 1950-60 përcaktojnë përfundimisht trajtimin e gjinive mbi bazën e standardeve tradicionale dhe jo thjesht si një mundësi për të shkruar në formacione instrumentale si duo, trio apo kuartet. Në vazhdimësi të procesit të konsolidimit të fizionomisë tradicionale, këtyre kritereve i përmbahet edhe Kuarteti Nr. 1 i Tonin Harapit.

Në dy dekadat në vazhdim 1970-90, muzika shqiptare e dhomës reflektoi ndryshimet e reja që solli koha. Veprat e shkruara në këtë fushë janë të pakta, por dy prej tyre mund të konsiderohen vërtet domethënëse. Përkatësisht, Sonata

për Violinë e Piano e Çesk Zadesë dhe Kuarteti i harqeve i Feim Ibrahimit dëshmojnë dy prirjet themelore zhvilluese që karakterizojnë ato vite: 1) spikatjen e individualiteteve krijuese përmes zhvillimit të një gjuhe të elaboruar kombëtare; dhe 2) kërkesën e afrimit të muzikës shqiptare me zhvillimet bashkëkohore të shekullit XX. Me sonatën e tij, Zadeja finalizoi përpjekjet e kahershme për kërkimin e një shprehjeje origjinale përmes përpunimit sistematik të elementeve me prejardhje nga karakteristikat gjuhësore folklorike. Nga ana tjetër, me kuartetin e harqeve Ibrahimit i hapi rrugë përfundimisht procesit të kalimit nga muzika tradicionale drejt asaj moderne shqiptare.

Së fundi duhet shënuar, që muzika e dhomës mbetet ndoshta fusha më pak e ndikuar nga propaganda politike. Me përjashtime të pakta (triot e L. Dizdarit), veprat e shkruara në këtë fushë paraqiten pa tituj programatikë, pra të përfshira në kategorinë e muzikës absolute.

## REFERENCAT

- Chaplin, E. William. 2013. *Analysing Classical Form*, Oxford University Press.
- Çefa, Sandër. 1965. "Shënime kritike rreth dy veprave të kompozitorit Tonin Harapi: Sonata në e-moll dhe Kuarteti i harqeve në D-dur, Tiranë: Revista "Nëntori"
- Çefa, Sandër. 1978. *Shënime kritike rreth dy veprave të kompozitorit Tonin Harapi*, Tiranë: SHBLU
- Dema, Ilirjana. 2010. *Gergj Antoniu, një jetë në violonçel*; Studim monografik, Tiranë: Shtëpia Botuese FLESH.
- Duka, Valentina. 2007. *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Kristalina-KH"
- Frashëri, Kristo. 2008. *Histori e Popullit Shqiptar – IV*, Tiranë: Botimet Toena.
- Hysi, Fatmir. 1992. "Çfarë do të mbetet nga arti dhe letërsia?", *Gazeta Drita*, 8 prill.
- Ibrahimit, Vera. 2023. *Vikama e Tingullit*, Tiranë: Onufri.
- Instituti i Lartë i Arteve, ILA. 1989. *Historia e muzikës shqiptare*, Volume 2, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar
- Krantja, Mustafa. 1954. "Folklorizëm dhe formë nacionale në muzikë", *Revista Nëntori*.
- Lara, Kozma. 1992. "Për një vështrim të ri të krijimtarisë", *Gazeta Drita*, 17 nëntor.
- Leotsakos, George. 2001. *The New Grove, Ibrahimit Feim, Dictionary of Music and Musicians*, 2nd Ed., Vol. 12, Oxford University Press
- Sokoli, Ramadan. 1965. *Folklori muzikor shqiptar*, Tiranë: Mihal Duri

- Shupo, Sokol. 2002. *Enciklopedia e muzikës shqiptare* (vëll. I), Tiranë: ASMUS
- Shuteriqi Prela, Zana. 2019. *Muzika Shqiptare. Pjesa e parë (1878-1940)*, Tiranë: Akademia e Shkencave
- Shuteriqi, Zana. 1976. "Mbi zhvillimin e muzikës sonë instrumentale të dhomës, *Revista Nëntori*, nr. 9, shtator.
- Tole, Vasil. 2022. *Çesk Zadeja në muzikën shqiptare* (jeta dhe vepra), Prishtinë: ASHAK.

## ABSTRACT

This paper focuses on the second phase in the development of chamber music in Albania, aiming to explore the processes involved in cultivating this professional musical genre in the country from 1945 to the end of the 1990s. Following a historical-analytical methodology, the study examines the most representative composers and their respective works. Among them are T. Daija with the First String Quartet (1956), T. Harapi with String Quartet No. 1 (1963), Limos Dizdari with Trio No. 1 for violin, cello, and piano (1974), Ç. Zadeja with the Sonata for violin and piano (1974), and F. Ibrahimimi with the String Quartet (1989). The analysis of this body of work leads to several conclusions: (1) chamber music occupies an important place in the musical creativity of the period; (2) the approach to genres is determined by their standard formal and dramaturgical requirements; and (3) unlike the general orientation of Albanian music of the time toward the formation of a national musical identity, Albanian chamber music preserved a traditionalist core, shaped by the aesthetics of 19th-century Romanticism, early 20th-century late Romanticism, and influences from Russian composers of the late 19th and 20th centuries. Based on these models, it clearly developed as a national music, with extensive use of musical material derived from folklore and traditional folk music.

**Keywords:** *Albanian musicians, professional music, chamber music, trio, quartet.*

NGA DIALOGU I HAPUR TE MONITORIMI  
I FSHEHTË: NDËRMJETËSIMI PRINDËROR,  
KONTROLLI DHE BESIMI NË MARRËDHËNIEN  
PRIND-FËMIJË NË EPOKËN  
DIGJITALE NË SHQIPËRI

Monika TAÇI

*Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale*

*Fakulteti i Shkencave Sociale*

*Universiteti i Tiranës*

E-mail: monikacenameri@yahoo.com

Eris DHAMO

*Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale*

*Fakulteti i Shkencave Sociale*

*Universiteti i Tiranës*

E-mail: eris.dhamo@unitir.edu.al

---

PËRMBLEDHJE

Revolucioni digjital ka transformuar ndjeshëm praktikatat e prindërimit dhe mënyrat e komunikimit prind-fëmijë, veçanërisht gjatë adoleshencës, një periudhë e karakterizuar nga ndryshime të shpejta zhvillimore. Ky studim synon të eksplorojë praktikatat e prindërimit digjital pozitiv si mekanizma komunikimi dhe ndërveprimi që nxisin besimin prind-fëmijë në realitetin shqiptar. Për realizimin e këtij kërkimi është përdorur një qasje cilësore me dizajn eksplorues, duke zhvilluar 19 intervista të thelluara dhe dy fokus grupe me prindër të adoleshentëve të moshës 13-16 vjeç në qytetin e Tiranës. Të dhënat e mbledhura gjatë periudhës dhjetor 2024 -mars 2025 u analizuan përmes analizës tematike. Gjetjet kryesore tregojnë se prindërit alternojnë ndërmjet formave të ndërmjetësimit aktiv, kufizues dhe monitorimit të fshehtë, praktika këto të ndikuara shpesh nga pasiguria, normat kulturore dhe perceptimi i ulët i kontrollit prindëror. Studimi evidenton se dialogu i hapur, fleksibiliteti dhe modelimi prindëror

janë elementë kyç për ndërtimin e besimit dhe ruajtjen e lidhjes emocionale në mjedisin digjital. Analiza pasqyron gjithashtu një ndarje gjinore në prindërimin digjital, ku nënat mbajnë peshën kryesore të ndërmjetësit të përditshëm, ndërsa baballarët priren të ndërhyjnë kryesisht si autoritet në situata të perceptuara si serioze. Punimi konkludon se prindërimi digjital pozitiv duhet të bazohet në dialog dhe prani emocionale, duke theksuar se bashkëjetesa me teknologjinë përmes mirëkuptimit është më efektive sesa përpjekjet për kufizim absolut. Ky hulumtim ofron një kontribut shkencor duke analizuar kontekstualisht prindërimin digjital në Shqipëri dhe nevojën për strategji të bazuara në përgjegjshmëri të ndërsjellë.

**Fjalë kyçe:** *prindërim digjital, adoleshencë, komunikim prind-fëmijë, besim, media sociale.*


Dr. **Monika TAÇI** është pedagoge me kohë të plotë në Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranë, ku zhvillon mësimdhënie dhe kërkim shkencor që prej vitit 2008. Ajo ka përfunduar studimet pasuniversitare në “Punë Sociale” në (2008) dhe në 2014 ka marrë gradën “Doktor” në Punë Sociale. Ka marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo aderon dhe kontribuon në rrjete profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare të punës sociale. Fusha e botimeve të saj përfshin tematika mbi të rinjtë dhe teknologjinë, internetin dhe rrjetet sociale, zhvillimin psiko-social të adoleshentëve, sfidat e edukimit dhe prindërimit në kontekste digjitale, si edhe etikën e punës sociale”.

Prof. Asoc. Dr. **Eris DHAMO** është pedagoge dhe kërkuese në fushën e shkencave sociale, me ekspertizë në politika sociale, te drejtat, çështje gjinore dhe mbrojtje sociale. Me përvojë të konsoliduar akademike dhe kërkimore, ajo kontribuon në zhvillimin e studimeve shkencore, promovimin e praktikave të bazuara në evidencë dhe përmirësimin e politikave sociale në Shqipëri.

## Hyrje


Sot, në epokën digjitale, përballemi gjithnjë e më shpesh me shqetësime lidhur me prindërimin e adoleshentëve, pasi përhapja e shpejtë e teknologjive dixhitale dhe rritja e aksesit në rrjetet sociale kanë sjellë sfida dhe ankth të shtuar për prindërimin dixhital. Mjedisi dixhital i shtëpisë në shumicën e rasteve përcakton se cilat praktika të prindërimit dixhital ndodhnin, kjo në kushtet kur familjet kanë një numër të madh pajisjesh si tableta me aplikacione të ndryshme, kompjutera, të paktën një televizor smart apo televizor me ekran të madh, telefona celularë jo vetëm për prindërit, por dhe për fëmijët, kompjuter (PC), ndonjëherë dhe altoparlantë dhe sistem zëri, monitorë në dhomat e gjumit të fëmijëve të vegjël, iPad, etj; gati “gjithçka”. Numri dhe lloji i teknologjive dixhitale ndryshon midis familjeve duke u dhënë fëmijëve akses të ndryshëm jo vetëm në mundësitë për përdorim, në numrin e

*Shpeshësia e përdorimit të TIK në Shqipëri tek grupmosha 16 - 24 vjeç, për vitet 2018-2025, në %*



platformave dhe rrjeteve ku mund të bëjnë pjesë, por dhe në kushtrëzimin e prindërve në zgjedhjen e praktikave për secilin rast

*Shpeshhtësia e përdorimit të TIK në Shqipëri tek grupmosha 16 - 24 vjeç, sipas gjinisë, për vitet 2018-2025, në %*



[Burimi: Instituti i Statistikave (INSTAT)- Shpërndarja e shpeshhtësisë së përdorimit të TIK sipas gjinisë 2018-2025 në %]

familjar, dhe në varësi të numtit dhe moshës së fëmijëve. Bazuar në perspektivën e tyre, prindërit vendosin se si fëmijët përdorin teknologjitë dixhitale në shtëpi (Neumann, 2018; Soyooof et al., 2024). Studimet kryesisht janë të fokusuar jo vetëm në ndikimin që teknologjitë dixhitale kanë në mirëqenien e adoleshentëve, por dhe në sfidat që prindërit kanë kur kërkojnë të adresojnë shqetësimet e tyre, ndonjëherë pa një plan veprimi të qartë. Ne duhet të kuptojmë sesa të shumta janë fushat që janë anashkaluar në studime mbi këtë çështje siç është shqyrtimi i përdorimeve pozitive të teknologjive dixhitale, njohja e ndikimit reciprok (dhe ai adoleshentë-prind) duke i kushtuar vëmendje heterogjenitetit nëpër familje dhe ekologjive sociale jo-prindërore të mbështetjes dhe monitorimit. Një përqindje e lartë studimesh kanë demonstruar përfitime të konsiderueshme të

fëmijëve të vegjël që fitojnë një sërë aftësish, përmes përdorimit të teknologjive dixhitale në shtëpi dhe vetëm 16.12% e studimeve raportojnë efekte negative të teknologjive dixhitale në kontekstin shtëpiak, duke përfshirë shpërqendrimin, sjelljen agresive dhe vetëbesimin e rremë (Soyooof, Reynolds, Neumann, Scull et al., 2024). Epoka digjitale ka sjellë një transformim të thellë në mënyrën sesi adoleshentët rriten dhe ndërveprojnë me botën përreth tyre, duke vendosur prindërit përballë sfidave të reja, të panjohura më parë në procesin edukues. Adoleshenca është ndër grupmoshat më të ekspozuara dhe më aktive në përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK), duke kaluar pjesën më të madhe të kohës në mjedise virtuale. Sipas studimit “Adoleshentët, Mediat Sociale dhe Teknologjia 2022” në SHBA, përqindja e adoleshentëve që përdorin

internetin “çdo ditë” është rritur nga 92% në vitin 2014-2015, në 97% në vitin 2022 (Vogels, Gelles & Massarat, 2022), duke reflektuar një tendencë globale drejt digjitalizimit intensiv të përvojës së adoleshentëve. E njëjta dinamikë është e dukshme edhe në Shqipëri, ku adoleshentët përbëjnë një segment pothuajse tërësisht të lidhur me botën digjitale. Është pothuajse e pamundur të gjesh, një adoeshent pa një celular të lidhur me internet, apo pa qenë pjesë e një rrjeti social.

Të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT) për vitet 2018-2025 tregojnë se përdorimi i internetit në grupmoshën 16-24 vjeç ka arritur përqindjen (99.4%) për frekuencën “disa herë në ditë”, duke dëshmuar një penetrim të madh të TIK-ut në jetën e përditshme të të rinjve.

Për më tepër, edhe përdorimi i internetit nga vetë prindërit ka ndjekur një trajektore në rritje, pa dallime të konsiderueshme gjinore, çka tregon një prani të dyfishtë familjare në botën online (INSTAT, 2025).

Në kontekstin e këtij realiteti gjithnjë e më të ndërthurur me teknologjinë, ndërmjetësimi prindëror paraqitet si një komponent qenësor në kuptimin dhe orientimin e sjelljeve dixhitale të fëmijëve. Literatura ekzistuese sugjeron se marrëdhënia prind-fëmijë në hapësirat virtuale ndikohet ndjeshëm nga mënyra se si adoleshentët e përvetësojnë dhe përdorin teknologjinë (Dürager & Livingstone, 2012). Kjo nënkupton një nevojë të qartë që prindërit të rishikojnë dhe përshtatin praktikatat e tyre edukative në përputhje me zhvillimet teknologjike, përmes një ndërmjetësimi aktiv që përfshin mbikëqyrje të arsyeshme, dialog të hapur dhe modelim të qëndrueshëm të sjelljes (Livingstone et al., 2015). Milford et al. (2022) në studimin e tyre nxorën në pah, prindërit dhe kujdestarët si ndikuesit kryesorë për

të përmirësuar, kufizuar dhe menaxhuar ndërveprimet dixhitale të fëmijëve.

## Shqyrtim literature

### *Qasje teorike të integruara*

Për të kuptuar më gjerësisht ndërveprimin kompleks midis prindërimit, teknologjisë dhe zhvillimit të adoleshentëve, ky studim mbështetet gjithashtu në dy teori themelore ndërdisiplinore: Teoria e Sjelljes së Planifikuar (Ajzen, 1991); Teoria e Sistemeve Ekologjike (Bronfenbrenner, 1979). Integrimi i këtyre dy teorive lejon një lexim të balancuar të sfidave të prindërimit digjital- si një bashkëjetesë midis qëndrimeve personale, strukturave sociale dhe vetë ndikimit formësues që teknologjia ushtron mbi mënyrën sesi fëmijët dhe prindërit ndërveprojnë në një realitet të ri kulturor dhe komunikativ.

### *Korniza Teorike: Prindërimi dhe Ndërmjetësimi në Epokën Digjitale*

Koncepte të rëndësishme që lidhen me prindërimin dhe sjelljen e adoleshentëve janë zhvilluar në dekada të ndryshme, duke nisur nga klasifikimi i stileve të prindërimit të propozuar nga Diana Baumrind (1966), e cila hodhi themelet për kuptimin e mënyrave se si prindërit ndikojnë në zhvillimin psikosocial të fëmijëve. Me avancimin e teknologjisë dhe përhapjen masive të internetit, vëmendja e studimeve është zhvendosur drejt mënyrës sesi prindërit menaxhojnë dhe ndërmjetësojnë përvojën digjitale të fëmijëve të tyre (Valcke et al., 2010). Në literaturën bashkëkohore, një nga konceptet kyçe është ai i ndërmjetësimit prindëror, i cili përkufizohet si një seri strategjish që synojnë të maksimizojnë përfitimet e përdorimit të internetit dhe të reduktojnë rreziqet që lidhen me të (Livingstone et al., 2017). Sipas modelit të propozuar

nga Livingstone et al. (2011), pesë janë format më të njohura të ndërmjetësimit prindëror: (a) ndërmjetësimi aktiv i përdorimit, që përfshin diskutimin dhe ndarjen e aktiviteteve online me fëmijët; (b) ndërmjetësimi aktiv i sigurisë, që konsiston në shpjegimin e rreziqeve dhe ndihmën përballë vështirësive në internet; (c) ndërmjetësimi kufizues, i cili vendos kufij kohorë apo përmbajtjesorë në përdorimin e teknologjisë; (d) kufizimet teknike, përmes përdorimit të filtrave apo mjeteve monitoruese; dhe (e) monitorimi pasiv, që nënkupton shqyrtimin e aktivitetit online të fëmijëve pas përdorimit. Studimet empirike tregojnë se ndërmjetësimi aktiv është forma më e përhapur si në SHBA ashtu edhe në Evropë. Clark (2013) vëren se shumica e prindërve amerikanë preferojnë dialogun dhe bisedën si strategji kryesore ndërmjetësimi, ndërsa në studimet evropiane (Kirwil, 2009; Livingstone et al., 2011; Livingstone et al., 2012), ndërmjetësimi aktiv renditet si praktika më e zakonshme ndër prindërit e fëmijëve të moshës 9-16 vjeç, e ndjekur nga udhëzimet për sigurinë dhe kufizimet teknike.

*Strategjitë e ndërmjetësimit prindëror në përdorimin e internetit nga adoleshentët*

Përpjekjet dhe strategjitë prindërore për të kuptuar, mbështetur dhe rregulluar aktivitetin dixhital të fëmijëve përcaktojnë mjediset fillestare dixhitale të fëmijëve (Fidan & Olur, 2023). Në literaturën bashkëkohore, ndërmjetësimi prindëror konsiderohet si një element kyç në menaxhimin e marrëdhënies fëmijë-internet. Raporti EU Kids Online 2020, i zhvilluar në 19 vende evropiane ndërmjet vjeshtës së vitit 2017 dhe verës së vitit 2019, ka konsoliduar termin “ndërmjetësim prindëror”, duke e konceptuar atë si përpjekjen sistematike të prindërve për të ndikuar në përvojën dixhitale të fëmijëve

të tyre (Livingstone et al., 2017). Ky raport dallon dy forma themelore të ndërmjetësimit: ndërmjetësimin mundësues dhe ndërmjetësimin kufizues. Ndërmjetësimi mundësues përfshin praktika që synojnë fuqizimin e fëmijëve për një përdorim aktiv, të sigurt dhe zhvillues të internetit. Në këtë kategori përfshihen ndërmjetësimi aktiv (diskutimi me fëmijët dhe ndarja e përbashkët e përvojës online) si dhe monitorimi teknik, që nënkupton përdorimin e teknologjisë për të ndjekur aktivitetin dixhital të fëmijëve në mënyrë jo-invazive. Nga ana tjetër, ndërmjetësimi kufizues përqendrohet në kufizimin e kohës së përdorimit ose të përmbajtjeve të aksesueshme, me qëllim reduktimin e ekspozimit ndaj rreziqeve virtuale. Sipas analizave të raportit, ndërmjetësimi aktiv rezulton të jetë strategjia më e dëshirueshme, pasi lidhet pozitivisht me zhvillimin e aftësive digjitale, rritjen e vetëdijes ndaj përmbajtjes online dhe përgatitjen e fëmijëve për të menaxhuar situata të mundshme problematike në internet (W. & Lwin, 2017). Megjithatë, ndërmjetësimi kufizues, ndonëse efektiv në uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve, është lidhur me ulje të kompetencave digjitale dhe një përgatitje më të dobët të fëmijëve për t'u përballur në mënyrë autonome me sfidat që sjell interneti (Livingstone et al., 2017). Gjetjet empirike të EU Kids Online tregojnë gjithashtu diferenca të ndjeshme ndërkombëtare në praktikën e ndërmjetësimit aktiv. Në 12 nga 19 shtetet e studiuara, shumica e fëmijëve raportojnë se prindërit e tyre flasin me ta, të paktën ndonjëherë, për aktivitetet online. Në Gjermani, Francë dhe Kroaci, më shumë se 80% e fëmijëve përfshihen në këto dialogë, ndërsa në vende si Zvicra, Spanja, Polonia dhe Republika Çeke, mbi gjysma e të rinjve pohojnë se nuk diskutojnë thujtë asnjëherë me prindërit për përvojën e tyre

digjitale (Smahel et al., 2020). Ndërkohë, rishikimet e fundit të literaturës theksojnë se cilësia e marrëdhënies prind-fëmijë dhe klima komunikative në familje janë faktorë përcaktues në parandalimin e rreziqeve online. Elsaesser et al. (2017) argumentojnë se ngrohtësia, bashkëpunimi dhe dialogu janë dukshëm më efektive sesa përdorimi i kufizimeve teknike apo strategjive kontrolluese. Përkundrazi, qasjet e rrepta dhe autoritare mund të çojnë në sjellje shmangëse nga ana e fëmijëve dhe në mospajtim me autoritetin prindëror (Third et al., 2019; Livingstone & Blum-Ross, 2020). Në këtë linjë, një numër autoritetesh profesionale, përfshirë Akademinë Amerikane të Pediatriës, rekomandojnë ndërmjetësimin aktiv dhe bashkëpërdorimin e teknologjisë si praktikat më të balancuara dhe efektive në ndërtimin e një marrëdhënieje të shëndetshme midis prindërve dhe fëmijëve në botën digjitale (Strasburger et al., 2013). Studimet kanë evidentuar që prindërit i njohin ndikimet negative të medias sociale në sjelljen e fëmijës së tyre, dhe kjo shoqërohet me mënyrën se si ata e shohin zhvillimin e funksionimit ekzekutiv të fëmijës së tyre (Milford et al. 2022). Rezultatet e studimeve theksojnë rëndësinë e edukimit të prindërve në lidhje me rolin e medias sociale në formësimin e sjelljes së fëmijës së tyre dhe funksioneve ekzekutive të shoqëruara (Milford et al. 2022).

## Aspekte metodologjike

### *Dizajni Studimor*

Ky studim mbështetet në një qasje kërkimore cilësore, pasi natyra eksploruese e studimit na mundëson të evidentojmë perceptimet e pjesëmarrësve dhe përvojat e tyre me praktikatat e suksesshme të prindërimit digjital. Natyra induktive e kërkimit cilësor lejon eksplorimin e temave të pahetuara

sa duhet dhe mund të kontribuojë në gjenerimin e hipotezave të reja duke rritur njohuritë rreth fenomeneve shoqërore dhe duke kapur pikëpamjet e personave të përfshirë, bazuar në përvojat e tyre të përditshme (Braun dhe Clarke, 2006; Merriam, 2014). Studiueset zgjodhën një studim kërkimor cilësor mbi atë sasi pas pas besojnë se ky është një problem dhe kërkon shqyrtim në vend që ta shohin vetëm nga një këndvështrim numerik ose i matshëm (Creswell & Poth, 2008). Prandaj, qëllimi i studimit ishte të identifikonte komponentët e prindërimit digjital, të cilët janë lënë pas dore ose nuk janë trajtuar deri më tani. Ky është një studim me fokus eksplorues, me synimin për të kuptuar në thellësi përvojat dhe qëndrimet e prindërve ndaj sfidave të prindërimit në kontekstin e shoqërisë digjitale. Metoda e kërkimit cilësor përdor supozime dhe korniza të ndryshme për të hetuar një problem që ndikon një person të vetëm ose një grup njerëzish (Creswell & Poth, 2018). Studimi aktual u krye duke përdorur një metodë konvencionale të analizës cilësore të përmbajtjes.

### *Pjesëmarrësit*

Pjesëmarrësit ishin të gjithë prindër të adoleshentëve, (mosha 13-16 vjeç), të cilët ndjekin arsimin bazë në ciklin e lartë në pesë shkolla publike në Tiranë. të cilët u përzgjedhën duke përdorur kampionimin homogjen të qëllimshëm, brenda të cilit u aplikua variacion maksimal (moshë, arsim, profesion). Kampionimi i qëllimshëm është zgjedhja më e mirë kur studiuesi ka nevojë për një grup njerëzish që janë më të njohur me fenomenin e kërkimit (Creswell & Poth, 2018). Procesi i marrjes së kampionimit vazhdoi deri në pikën e ngopjes së të dhënave. Përzgjedhja e kampionit me variacion maksimal synon të marrë një grup të larmishëm pjesëmarrësish të përshtatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve

të kërkimit (Schwandt, 2014). Të dhënat u ngopen me 19 pjesëmarrës (12 gra dhe 7 burra), në procesin e intervistave të thelluara dhe nuk doli asnjë informacion i ri në intervistën e fundit.

Për të pasuruar më tej analizën dhe për të identifikuar dinamika grupore në raport me përdorimin e teknologjisë, janë zhvilluar gjithashtu edhe fokus grupe me pjesëmarrës të përzgjedhur nga e njëjta kategori. Fokusgrupet e formuara ishin 2, në të parin kishte 7 pjesëmarrës dhe në të dytin 11 pjesëmarrës. Kriteret e përfshirjes ishin gatishmëria për të marrë pjesë në këtë studim, të kesh të paktën një fëmijë në moshën 13-16 vjeç, fëmija të jetë përdorues i teknologjisë për më shumë se 3 orë në ditë, fëmija të jetë aktiv dhe i përfshirë në media sociale. Kriteri i përjashtimit ishte largimi nga studimi në çdo fazë të mbledhjes së të dhënave për të gjithë pjesëmarrësit. Pasi morën pëlqimin e informuar nga pjesëmarrësit dhe shpjeguan objektivat e studimit, studiueset u siguruan

pjesëmarrësit se informacioni i dhënë prej tyre dhe identiteti i tyre do të mbeteshin plotësisht konfidencial. Pjesëmarrësit u siguruan gjithashtu se bisedat e regjistruara do të fshiheshin pasi të përfundonte analiza. Pyetjet e intervistës u formuluan në mënyrë koherente duke shqyrtuar literaturën si dhe duke anketuar ekspertë të fushës. Në intervistë gjendeshin pyetje gjysmë të strukturuar me pyetje të hapura dhe pyetje pasuese për të inkurajuar pjesëmarrësit të ndanin përvojat e tyre. Shembuj të pyetjeve ishin: “A mund ta përkufizoni prindërimin gixhital?” dhe “Çfarë metodash sjelljeje përdorin prindërit e suksesshëm për të rritur fëmijët e tyre në epokën digjitale?” Për më tepër, pyetje pasuese (A mund të shpjegoni më shumë rreth kësaj? ose Çfarë doni të thoni?) u kërkuan për sqarime të mëtejshme. Çdo intervistë zgjati 35-65 minuta, dhe koha dhe vendi i intervistës u përcaktuan paraprakisht nga studiueset me pëlqimin e pjesëmarrësit. Fokus grupet u organizuan në dy mjedise të ndryshme,

**Tabela 1:** Të dhënat demografike të pjesëmarrësve në studim

	Intervista	Fokus Gupe
Mosha		
≤ 39	11	6
40-49	7	9
≥ 50	1	3
Gjinia		
Burrë	7	13
Grua	12	5
Status martesor		
Martuar	15	16
I/E Ve	1	-
Divorcuar	3	2
Punësimi		
Shtëpiak (e)	1	5
I/E Punësuar	8	6
I/E Vetëpunësuar	10	7
Edukimi		
Elementar	-	1
I/E Mesëm	2	1
I/E Lartë	17	16

njëri në qendër të Tiranës dhe tjetri në periferinë verilindore, në mjedise lehtësisht të aksesueshme nga prindërit.

Të gjithë pjesëmarrësit janë kontaktuar përmes një ftese paraprake, ku janë informuar për qëllimin e studimit dhe janë dakordësuar në mënyrë vullnetare për të marrë pjesë në intervista dhe diskutime. Procesi i grumbullimit të të dhënave është zhvilluar gjatë periudhës dhjetor 2024-mars 2025. Tabela 1 tregon karakteristikat demografike të pjesëmarrësve.

## Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura u analizuan duke përdorur analizën tematike, e cila është një teknikë për njohjen, analizimin dhe raportimin e modeleve në të dhënat cilësore. Kjo teknikë e analizës së të dhënave përdoret për të transformuar të dhënat e shpërndara dhe të larmishme në të dhëna të pasura dhe të detajuara. Analiza tematike lejoi identifikimin e temave dhe nën-temave kritike në zhvillim e sipër dhe informacionit të rëndësishëm dallues (Clarke & Braun, 2014; Vaismoradi et al. 2013). Kodimi fillestar induktiv i të dhënave të intervistës grupoi fjalë, fraza ose ngjarje me kuptime të ngjashme në të njëjtën kategori (Clarke & Braun, 2014). Analiza u përqëndrua në identifikimin e praktikave pozitive të prindërimit digjital dhe mekanizmave komunikuese e ndërvepruese që nxisësin besimi prind-fëmijë. Dy studiuëset (M.T & E.Dh) koduan në mënyrë të pavarur të dhënat, përpara se të diskutonin kodet për të thelluar interpretimin. Organizimi i temave ishte teorikisht i orientuar, ato u zhvilluan përmes një procesi përsëritës, të mbështetur nga diskutime të rregullta. Praktikrat e prindërimit dixhital dhe strategjitë e ndërveprimit dolën si tema kryesore, të cilat më pas u përdorën si një

lente për të analizuar më tej në mënyrë deduktive grupet e të dhënave. Analiza dha një pasqyrë se çfarë përfshinte secila praktikë dhe strategji e prindërimit dixhital dhe strukturoi gjetjet. Ngopja e të dhënave u vlerësua jo vetëm në nivelin e përsëritjes së kodeve, por edhe në nivelin e thellësisë dhe pasurisë së kuptimeve të përvojave të raportuara, në përputhje me dallimin midis ngopjes së kodeve dhe ngopjes së kuptimit (Hennink et al., 2017; Guest et al., 2013).

Analiza tematike u krye në këtë studim në gjashtë hapa: Njohja me të dhënat, gjenerimi i kodeve parësore, kërkimi i temave, rishikimi i kodeve dhe rishikimi i temave, përcaktimi dhe emërtimi i temave dhe përgatitja e një raporti gjetjesh (Braun & Clarke, 2006). Besueshmëria e të dhënave në këtë studim u kontrollua duke përdorur katër kritere të veçanta (besueshmëria, transferimi, konfirmueshmëria dhe besueshmëria) të propozuara nga Guba dhe Lincoln (1994). Për të vlerësuar besueshmërinë e të dhënave, pas analizimit të secilës intervistë, përmbajtja e saj u diskutua me pjesëmarrësit, në formën e një konfirmimi vërtetësie, për të garantuar besueshmërinë e rezultateve dhe për të aplikuar rishikimet e nevojshme. Për të rritur transferimin e gjetjeve, të intervistuarit u përzgjedhën me variacion maksimal në aspektin e profesionit, arsimit dhe moshës për të eksploruar fenomenin në fjalë në një mjedis të zgjeruar. Për të siguruar konfirmueshmërinë e gjetjeve, dy studiuëset shqyrtuan raportet dhe transkriptet dhe konfirmuan saktësinë e gjetjeve.

Në respekt të standardeve etike të kërkimit shkencor, pjesëmarrësit janë informuar për të drejtën e tyre për të refuzuar ose ndërprerë pjesëmarrjen në çdo moment, si dhe për garantimin e anonimatit dhe konfidencialitetit të informacionit të ofruar. Të dhënat e mbledhura janë trajtuar me kujdes të veçantë për të shmangur çdo

formë identifikimi dhe për të mbrojtur privatësinë individuale të subjekteve të përfshira në hulumtim.

### *Objektivat specifikë të studimit*

Të eksplorojë përvojat dhe kuptimet që prindërit shqiptarë i atribuojnë prindërimit digjital, duke analizuar mënyrat se si ata përjetojnë dhe interpretojnë sfidat e rritjes së adoleshentëve (13-16 vjeç) në një mjedis familjar të ndërmjetësuar nga teknologjia.

Të identifikojë dhe kategorizojë strategjitë e ndërmjetësimit prindëror në përdorimin e internetit dhe mediave sociale nga adoleshentët, si dhe tensionet komunikative dhe dilemat edukative që shoqërojnë këto praktika në nivel mikro dhe makrosocial.

Të analizojë rolin e dialogut, besimit dhe strukturave gjinore në ndërtimin dhe riformësimin e marrëdhënies prind-adoleshent në kontekstin digjital, duke evidentuar nevojën për modele të qëndrueshme të prindërimit digjital pozitiv dhe mbështetje institucionale.

Studimi paraqet një përmbledhje dhe sintezë gjithëpërfshirëse të të dhënave të grumbulluara mbi qëndrimet, praktikat dhe strategjitë e ndërmjetësimit prindëror. Vlen të përmendet se analiza u realizua në dy hapa. Në hapin e parë njëra nga studiueset analizoi të dhënat e intervistave dhe më pas të dhënat e focus grupeve u përdorën për të konfirmuara (ose jo) përfundimet e temave të nxjerra nga analiza e intervistave. Qëllimi i këtij studimi ishte të përshkruante përvojat e prindërve të fëmijëve adoleshentë në lidhje me përpjekjet e tyre për të kultivuar një mjedis teknologjik dhe digjital, sfidues për ta dhe për fëmijët e tyre të përfshirë gjatë në të. Ky hulumtim eksplori se si prindërit përballojnë sfidat e mirërritjes, ndërsa përbushin nevojat teknologjike të fëmijëve të tyre. Duke shqyrtuar

perspektivat e këtyre prindërve duke përdorur një pyetje qendrore kërkimore dhe tre nën-pyetje, u përftua një kuptim më i thellë në lidhje me strategjitë për një komunikim efektiv të përdorura nga prindërit e fëmijëve adoleshentë duke evidentuar dhe ndërhyrjet e integruara për të përmirësuar ndjenjat e mbështetjes, sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve të tyre.

### **Diskutim i Gjetjeve**

Gjetjet e studimit tregojnë se përdorimi i hershëm dhe intensiv i pajisjeve digjitale dhe i mediave sociale po rikonfiguron mënyrën e ndërveprimit prind-fëmijë, duke e zhvendosur prindërimin nga forma tradicionale e kontrollit drejt strategjive të reja ndërmjetësimi prindëror. Prindërit raportojnë përdorimin e një spektri strategjish që variojnë nga dialogu i hapur dhe vendosja e rregullave, deri te monitorimi i fshehtë dhe ndërhyrjet reaktive pas situatave problematike online. Këto praktika reflektojnë tensionin midis dëshirës për mbrojtje dhe pasigurisë prindërore përballë një mjedisi digjital që perceptohet si i vështirë për t'u kontrolluar.

### *Strategji të shumëllojshme ndërmjetësimi prindëror në kontekstin digjital: ndërmjet normave, pasigurisë dhe ritmeve teknologjike*

Prindërit shqiptarë zbatojnë forma të ndryshme të ndërmjetësimit prindëror (parental mediation), të ndërtuara mbi përvoja personale, norma familjare dhe perceptime individuale mbi rrezikun digjital. Në mungesë të një modeli të institucionalizuar të prindërimit digjital, strategjitë ndërmjetësuese mbeten të fragmentuara dhe të varura nga niveli i vetëdijes dhe kontrollit që prindërit mendojnë se ushtrojnë mbi përdorimin e teknologjisë në familje.

Një pjesë e konsiderueshme e prindërve raportuan përdorimin e dialogut të drejtpërdrejtë dhe vendosjen e rregullave të qarta për përdorimin e internetit dhe mediave sociale. Këto praktika synojnë strukturimin e kohës online, mbrojtjen nga rreziqet dhe nxitjen e përgjegjshmërisë tek adoleshentët. Siç shprehet një nënë e një vajze 13-vjeçare (P6):

“...me vajzën time kam ndërtuar një dialog të hapur për përdorimin e internetit. Kemi diskutuar qartë sesa kohë duhet të kalojë online gjatë ditëve të javës dhe në fundjavë, si dhe arsytet pse kjo kohë duhet të jetë e kufizuar. Një nga rregullat më të rëndësishme që i theksoj vazhdimisht (për shkak të moshës 13 vjeçare) është që të mos komunikojë kurrë me persona të panjohur në internet. ‘Mos fol me të panjohur online’ është për ne një vijë e kuqe. Vendosja e kufijve për sjelljen online të vajzës time është shumë e rëndësishme për mua, megjithëse ndonjëherë bëhet e shumë e vështirë sepse vajza më tregon se ka bashkëmoshatarë, prindërit e të cilëve nuk i’u vendosin asnjë kufizim apo rregull në përdorimin e internetit apo sjelljen online.”

Në dritën e Teorisë së Sjelljes së Planifikuar (Ajzen, 1991), këto praktika pasqyrojnë ndikimin e bindjeve prindërore mbi rreziqet digjitale, normave subjektive të rolit prindëror dhe perceptimit të aftësisë për të ushtruar kontroll edukativ. Prindërit në studim shprehën pasiguri dhe mungesë udhëzimesh të qarta për rolin e tyre në epokën digjitale, veçanërisht në lidhje me përdorimin e mediave sociale nga vajzat. Në këto diskutime u evidentua një pasiguri e vazhdueshme e prindërve për kufirin midis asaj që ata e perceptojnë si ‘prind i mirë’ dhe ‘prind i keq’. Prindi i keq u përshkrua ai që është i paimentuar, nuk monitoron dhe nuk përfshihet në jetën

digjitale të fëmijës. Në të kundërt, prindi i mirë ai që përpiket të kuptojë, të vendosë kufij dhe të jetë i pranishëm, edhe pse kjo është e vështirë dhe shpesh pa modele të qarta. Nd’rsa babi i një vajze 16 vjeçare u shpreh se:

“E kuptoj që nuk është e mundur të kontrolloj në çdo moment komentet, mesazhet apo ndërveprimet online të vajzës sime. Megjithatë, përpikem të jem i vëmendshëm ndaj asaj që ajo poston dhe mënyrës se si komunikon në rrjetet sociale. Këtë nuk e shoh si kontroll, por si mbajtje të ‘syve hapur’ ndaj asaj që ndodh me vajzën time. Nuk e di nëse kjo më bën një prind të mirë apo një prind të keq.”

*Dimensioni makro: shteti si “super-prind” rasti i mbylljes së TikTok-ut*

Vendosja e rregullave për përdorimin e internetit nga fëmijët e moshës 13-16 vjeç perceptohet gjerësisht nga prindërit shqiptarë si një mekanizëm i rëndësishëm mbrojtës dhe edukativ i orientuar drejt menaxhimit të rreziqeve që shoqërojnë ekspozimin e adoleshentëve në hapësirën digjitale. Ky diskurs prindëror u reflektua edhe në vendimin e marrë nga qeveria shqiptare në dhjetor 2024 për mbylljen e përkohshme të platformës TikTok për një periudhë njëvjeçare, në një kohë kur ajo numëronte mbi një milion përdorues aktivë, kryesisht të rinj. Kjo ndërhyrje institucionale u motivua nga një ngjarje tragjike, ku një djalë 14-vjeçar humbi jetën pas një konflikti të nisur në rrjetet sociale, duke riafirmuar perspektivën sociologjike sipas së cilës hapësira digjitale nuk përbën një sferë të ndarë nga realiteti social, por një zgjatim të tij. Në opinionin publik shqiptar, vendimi për mbylljen e TikTok-ut u mirëprit gjerësisht nga prindërit e fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilët e interpretuan atë si një akt mbrojtës të shtetit përballë

dështimit të mekanizmave individuale të kontrollit prindëror. Megjithatë, kjo masë u shoqërua edhe me kundërshtime nga një pjesë e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë publikë, të cilët argumentuan se ndalimi i plotë i platformave online përbën një zgjidhje problematike. Në këtë kuadër, u artikulua shqetësimi se masa të tilla kufizuese mund të bien ndesh me standardet e lirisë së shprehjes, duke iu referuar praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në disa raste ka konstatuar se kufizimet disproporcionale të aksesit në platformat digjitale mund të bien në kundërshtim me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Qëndrimet e prindërve të adoleshentëve në këtë kontekst të polarizuar, pasqyrojnë nevojën për ti mbrojtur fëmijët. Kjo qasje reflektohet qartë edhe në dëshmitë prindërore. Siç shprehet nëna e një djali 15-vjeçar: “E kam ndaluar djalin tim të ndjekë influencër toksikë që promovojnë modele problematike të sjelljes mashkullore, si një influencer amerikano-britanik me iniciale A.T., i cili është shumë i përhapur në TikTok.” Shqetësime të ngjashme u evidentuan edhe lidhur me ndikimin e figurave publike shqiptare në rrjetet sociale. Disa prindër përmendën konkretisht influencën e një reperi shqiptar me iniciale R.R., i vetëquajtur si N, një figurë kontroverze, mjaft e ndjekur nga të rinjtë dhe adoleshentët, e kritikuar për promovimin e luksit ekstrem, dhunës dhe sjelljeve antisociale. Kjo figurë është përmendur në disa raste edhe në kontekste problematike ligjore, ndërkohë që paradoksalisht ka qenë i pranishëm edhe në materiale shkollore, duke nxitur konfuzion tek prindërit mbi mesazhet që u transmetohen të rinjve.

Kalimi nga masa ndëshkuese spontane drejt një qasjeje më reflektive dhe të negociuar u përshkrua nga disa

prindër si një përpjekje për të rindërtuar marrëdhënien edukative në kushte të reja digjitale. Kjo lëvizje është në përputhje me Teorinë e Sistemeve Ekologjike të Bronfenbrenner (1979), e cila e kupton sjelljen prindërore si produkt të ndërveprimit midis mikrosistemit familjar dhe faktorëve makrosocialë të epokës digjitale. Kjo konfirmohet dhe nga Nina (P 16) një nënë e një vajze 15-vjeçare:

“Përpara se të vendosnim disa rregulla për përdorimin e internetit në shtëpi, e gjeja veten duke fikur internetin, duke iu sekuestruar fëmijëve telefonin dhe duke i kërcënuar se nuk do t’ua ktheja. Shumë episode të tjera... Derisa një ditë vendosëm të ulëshim dhe ta zgjidhnim problemin e kohës së shpenzuar në internet përmes disa rregullave të përbashkëta.”

*Ndërmjetësimi prindëror i aktiviteteve online: kontroll i fshehtë dhe tensione komunikative*

Një temë e përsëritur në gjetjet e studimit ishte monitorimi i fshehtë i aktiviteteve online të adoleshentëve. Shumica e prindërve referojnë se kjo ndodh kryesisht e udhëhequr nga dëshira dhe përgjegjësia prindërore për të mbrojtur fëmijët ndërkohë kur mungojnë mjetet e tjera për ta bërë këtë në mënyrë të hapur e të besueshme. Kjo formë ndëveprimi shfaqet si përgjigje ndaj pasigurisë prindërore dhe perceptimit të ulët të kontrollit mbi hapësirën digjitale. Nëna e një vajze 14 vjeçare “I shikoj të gjitha postimet e vajzës time në Instagram, shoh kush e komenton dhe i bën like (pëlqen).....por hera-herës i marr edhe telefonin fshehurazi dhe ia kontrolloj” Prindërit raportuan praktika të tilla si kontrolli i pajisjeve pa dijeninë e fëmijëve apo krijimi i profileve të rreme për të ndjekur aktivitetin online. Kjo sjellje krijon “tensione komunikative” dhe mund të minojë besimin.

Në përputhje dhe me Teorinë e Sistemeve Ekologjike të Bronfenbrenner (1979), prindërit ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në mënyrën se si fëmijët ndërveprojnë me teknologjinë përmes zgjedhjeve që bëjnë në mikrosistemin familjar. Siç tregon Andi, një baba i një vajze 16-vjeçare (P12): “I blemë telefonin që kur ajo ishte në klasën e parë, sepse ndiheshim më të qetë që mund ta kontaktonim. Por për të qenë të sigurtë, ia kontrollonim telefonin fshehurazi, pa dijeninë e saj.” Një tjetër nënë përshkroi një rast ekstrem të kontrollit të fshehtë (P5): “Dy vjet më parë, hapa një profil fallco në internet me emrin e një vajze për të kontrolluar se çfarë bënte im bir online. Ai nuk e kuptoi asnjëherë.”

Këto praktika monitorimi, të cilat shpesh ndodhin jashtë një kornize të qartë etike apo komunikative, përfaqësojnë një përpjekje për të ruajtur kontrollin në një mjedis ku perceptohet mungesa e autoritetit tradicional. Në dritën e Teorisë së Sjelljes së Planifikuar (Ajzen, 1991), këto sjellje mund të interpretohen si produkte të një perceptimi të ulët të kontrollit prindëror dhe një norme subjektive që nxit mbikëqyrjen për shkak të frikës nga rreziqet online. Adolessenca u përshkrua gjerësisht si periudha më sfiduese për të vendosur një marrëdhënie dialoguese për çështje që lidhen me teknologjinë. Prindërit përmendën shprehje të përsëritura nga adolessentët, të tilla si: “nuk jam më fëmijë”, “e di vetë çfarë bëj”, “ti nuk kupton, edhe po të ta shpjegoj”, “mos e bëj dramë”, “mos e merr personale”, “po reagon tepër”, duke kulmuar në raste të caktuara edhe me shprehje të forta emocionale si “të urrej”. Këto fraza përfaqësojnë rezistencën ndaj autoritetit që transformohet në ndikimin e realitetit digjital.

### *Ndikimi i rrjeteve sociale në vetëvlerësimin e adolessentëve dhe sfidat e prindërimit digjital*

Në epokën e mediave sociale, vetëvlerësimi i adolessentëve po formësohet ndjeshëm nga ndërveprimet e tyre virtuale. Të dhënat e studimit tregojnë se shumica e prindërve shqiptarë shprehin shqetësim për ndikimin e rrjeteve sociale mbi perceptimin që fëmijët kanë për trupin, identitetin dhe vlerën personale. Ky shqetësim mbështetet teorikisht nga Teoria e Krahasimit Social (Festinger, 1954), sipas së cilës krahasimi i vazhdueshëm me të tjerët - karakteristikë e shfletimit të përmbajtjeve digjitale - mund të ndikojë negativisht në vetëvlerësimin, sidomos tek moshat e reja. Prindërit raportuan se adolessentët i konsiderojnë “like”-et dhe ndjekësit si njësi matëse të vetëvlerësimit. Nëna e një vajze 15-vjeçare theksoi (P12): “Në kohët e sotme gjithçka bëhet për të qenë i lezetshëm on-line... numri i ndjekësve është bërë baraz me vlerën që ndjen për veten.” Ky perceptim i ndikuar nga estetika e pamjes vizuale të kuruar dhe të idealizuar që dominohet në mediat sociale çon shpesh në ndjenja pamjaftueshmërie dhe mospërputhjeje midis vetes reale dhe asaj të prezantuar online – siç argumentojnë Daniels & Willard (2023). Në këtë kontekst, edhe Teoria e Vetëprezantimit (Goffman, 2016) ndihmon në interpretimin e përpjekjeve të adolessentëve për të ndërtuar identitete të menaxhuara në rrjet, të cilat nuk përputhen gjithmonë me përvojën personale, e rëndësishme kjo për menaxhimin e përshtypjeve dhe identitetit aq të rëndësishme për adolessentët. Kjo mospërputhje e thelluar nga algoritmet e përforcuara të mediave, rrit nevojën për ndërmjetësim prindëror të vetëdijshëm dhe dialog. Prindërit e intervistuar shprehën shqetësimin për këtë ndarje mes botës reale dhe virtuale dhe nevojën për të ndihmuar

adoleshentët të bëjnë dallimin midis tyre. Siç u shpreh Endi (P8) nëna e një vajze 14-vjeçare: “Për ta përforcuar mesazhin që kam përcjell tek vajza ime për atë që ndodh në internet, kam huazuar një proverb që thotë: ‘Jo çdo gjë që shkëlqen është flori.’”.

*Roli i baballarëve në dialogun digjital: vazhdimësia e roleve gjinore në ndërmjetësimin prindëror*

Roli i baballarëve në jetën e adoleshentëve mbetet i rëndësishëm, por shpesh më pak i dukshëm në kujdesin e përditshëm dhe ndërveprimin edukativ. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se përfshirja e baballarëve shqiptarë në ndërmjetësimin digjital me fëmijët e tyre adoleshentë është dukshëm më e kufizuar në krahasim me atë të nënave. Baballarët u shprehën se adoleshentët përgjithësisht janë më të afërt me nënat, kryesisht për shkak të karakteristikave të prindërimit që ato ushtrojnë. Ata i perceptojnë nënat si më interaktive, më mbështetëse dhe më pak kontrolluese.

Ndërkohë, baballarët, veçanërisht ata që mbajnë role dominuese dhe superior brenda familjes, raportojnë vështirësi në nisjen e bisedave me fëmijët e tyre adoleshentë për çështje që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe mediave digjitale. Për këtë arsye, ndërmjetësimi prindëror delegohet shpesh tek nënat, të cilat përshkruhen si më të pranishme në përditshmërinë e fëmijëve dhe më të afta për të menaxhuar sfidat edukative që lidhen me socializimin digjital. Ia si u shpreh Henri (P 10) njëri prej baballarëve:

“Mendoj se nëna është më e afërt emocionalisht me fëmijët dhe, siç themi ne, e *gjen më kollaj fjalën* në përditshmëri. Për këtë arsye, zakonisht është bashkëshortja ime/nëna e fëmijëve ajo që merrret me bisedat dhe vendosjen e rregullave, përfshirë

edhe orientimin e sjelljes së fëmijëve në lidhje me aktivitetin e tyre online. Unë, nga ana ime, ndërhyj vetëm kur situata bëhet serioze, kur ‘duhet të flasë babai’, pra në raste që kërkohet një autoritet më i fortë.”

Kjo dinamikë përforcon konstatimet teorike mbi ndarjen tradicionale të roleve gjinore në familje, të cilat, ndonëse në ndryshim, vijnë në strukturë praktikë prindërore në shoqërinë shqiptare.

Të dhënat nga studimi “Gratë në Republikën e Shqipërisë 2022-2023” e konfirmojnë këtë prirje, duke theksuar se 78% e grave e perceptojnë veten në funksione primare familjare, ndërsa babai vazhdon të shihet si autoriteti përfundimtar në vendimmarrje (Shehu, Danaj, Kocaqi & Sulçe, 2022-2023). Në këtë kontekst, roli i kufizuar i baballarëve në dialogun digjital reflekton jo vetëm një hendek komunikimi, por edhe një vazhdimësi të strukturave tradicionale të pushtetit gjinor në familje, të cilat ndikojnë në mënyrën sesi ndërtohet dhe shpërndahet autoriteti edukativ në epokën digjitale.

*Ndërmjetësimi prindëror përballë fragmentimit të gjubës digjitale: sfida të reja në ndërtimin e dialogut familjar*

Shfaqja e një forme të re komunikimi digjital, e përbërë nga shkurtesa, emoji dhe forma të kodifikuara të komunikimit të ndërtuara përmes rrjeteve sociale, po transformojnë thellësisht mënyrën sesi adoleshentët shprehën dhe ndërveprojnë. Ky ndryshim po riformulon edhe raportin komunikativ brenda familjes, duke prodhuar një formë të re heshtjeje-jo si mungesë zëri, por si humbje e përbashkësisë kuptimore midis brezave. Të dhënat e studimit tregojnë se prindërit ndihen gjithnjë e më të përjashtuar nga universi simbolik i adoleshentëve, sidomos në marrëdhëniet me djemtë, për të cilët

reduktimi i komunikimit verbal përjetohet me shqetësim të thellë. Siç dëshmon një nga baballarët e intervistuar: Keli (P 13)

Vitet e fundit e kisha dëgjuar shpesh atë shprehjen” *shyqyr që iku interneti, se vetëm atëherë i njoha njerëzit e shtëpisë*” por kurrë nuk e kisha menduar se do të ishte kaq e vërtetë. Sot e gjej veten duke u lutur që të iki interneti, vetëm që të kem mundësi të flas me tim bir dhe të kem mundësi ta njoh. Edhe pse jetojmë në të njëjtën shtëpi, flasim shumë pak dhe ndonjëherë kam ndjesinë e hidhur se pothuajse nuk e njoh djalin tim.”

Aftësitë e avancuara digjitale dhe nivelet e larta të shkrim-leximit mediatik të adoleshentëve u evidentuan qartë gjatë intervistave me prindërit. Prindërit theksuan se përpjekjet e tyre për të ndërvepruar me fëmijët rreth përdorimit të pajisjeve dhe përmbajtjeve digjitale rezultojnë shpeshherë të kufizuara ose jo plotësisht të suksesshme, duke reflektuar ekzistencën e një hendeku të theksuar kompetencash ndërbrezore në përdorimin dhe kuptimin e teknologjisë. Shumica e prindërve pohuan se fëmijët e tyre janë në gjendje të navigojnë me shpejtësi në mjediset digjitale, të manipulojnë ekranet (p.sh. ti zmadhojnë ose ti zvogëlojnë), të ndërveprojnë përmes lëvizjeve të shpejta, të anashkalojnë reklamat, të realizojnë dhe të modifikojnë përmbajtje vizuale, si dhe të kërkojnë, përzgjedhin dhe shkarkojnë përmbajtje në mënyrë të pavarur. Për më tepër, prindërit vunë në dukje se adoleshentët u përgjigjen pyetjeve ose problemeve teknologjike me shpejtësi dhe strategji të ndryshme nga ato të prindërve, shpesh pa e verbalizuar procesin, por duke e realizuar drejtpërdrejt në praktikë. Për shembull, Miranda (P 9) deklaroi se fëmija i saj mund të “na zgjidh të gjithë problemet me logimet në internet dhe vështërisë e ndryshme që në në familje

hasim me përdorimin e telefonit si “kërko përpara, dua atë, kërko më shumë në atë mënyrë” dhe të mos komunikojmë më për asgjë tjetër gjatë kohës së mbetur.”.

#### *Prindërimi digjital në kohën e ‘like’-ve dhe algoritmeve: rikrijimi i afërsisë emocionale në epokën e ekranit*

Në kontekstin e një shoqërie gjithnjë e më të ndërmjetësuar nga teknologjia, prindërimi digjital përballet me sfidën e ruajtjes së lidhjes emocionale në kushtet e pranisë gjithnjë e më dominuese të pajisjeve digjitale në jetën e përditshme të adoleshentëve. Distanca emocionale në prani fizike ndoshta është ajo që përfaqëson më së miri këtë situatë. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se prindërit shqiptarë ndjehen të sfiduar nga fakti që janë platformat sociale dhe jo më hapësirat fizike tradicionale që formësojnë stilet e jetës, shijet kulturore dhe vetë-perceptimet e fëmijëve të tyre. Përdorimi intensiv i teknologjisë në familje ka krijuar një mjedis ku fëmijët, ndonëse fizikisht të pranishëm, shpesh janë emocionalisht të tërhequr në botën virtuale. Prindërit përshkruajnë një ndjesi të distancës simbolike, ku bisedat ndërpriten nga ekrane të ndritshme dhe lidhjet emocionale zëvendësohen nga ajo që ndodh në internet. Një nga nënat shprehet se (P1)

“Edhe kur vajza ime është fizikisht në shtëpi, ajo është plotësisht e përqendruar në telefon. Telefoni i është bërë si një gjymtyrë shtesë dhe jeta e saj duket e pakuptimtë pa internet. Nëse dikush do të më pyeste se ku ndodhet vajza ime? Fatkeqësisht ka vetëm një përgjigje të saktë-online”.

#### **Përfundime dhe sugjerime**

Ky studim tregon se prindërimi në epokën digjitale në kontekstin shqiptar po kalon

një proces të dukshëm rikonfigurimi, i cili ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si ndërtohen dhe menaxhohen marrëdhëniet prind-adoleshent. Përdorimi intensiv i teknologjisë digjitale nga adoleshentët, transformimi i kodeve tradicionale të komunikimit dhe rishpërndarja e autoritetit prindëror kanë ndryshuar ndjeshëm dinamikat e ndërveprimit brenda familjes, duke e bërë komunikimin familjar më të fragmentuar dhe më të vështirë për t'u strukturuar në mënyrë efektive.

Gjetjet empirike evidencojnë se prindërit shqiptarë përdorin një spektër të gjerë strategjish të ndërmjetësimit digjital, të cilat variojnë nga praktikatat aktive dhe dialogjike deri te masat kufizuese dhe reaktive. Ndërmjetësimi aktiv digjital, i karakterizuar nga përfshirje proaktive, diskutime shpjeguese dhe orientim të vazhdueshëm mbi përmbajtjet digjitale, rezulton më funksional për ndërtimin e besimit dhe ruajtjen e lidhjes emocionale prind-adoleshent. Në të kundërt, ndërmjetësimi kufizues, i manifestuar përmes ndërprerjes së aksesit në internet ose vendosjes së rregullave strikte, ndonëse

i motivuar nga shqetësime legjitime për sigurinë, shpesh shoqërohet me tensione komunikative dhe rrezikon të dobësojë marrëdhënien edukative, veçanërisht kur nuk shoqërohet me dialog dhe sqarim.

Studimi nxjerr gjithashtu në pah se praktikatat e prindërimit digjital janë të strukturuar nga ndarje gjinore të qëndrueshme. Nën rezultatet aktorët kryesorë të ndërmjetësimit të përditshëm digjital, ndërsa baballarët shpesh pozicionohen në role më të distancuara, duke ndërhyrë kryesisht në situata të perceptuara si problematike ose serioze. Kjo ndarje reflekton vazhdimësinë e modeleve tradicionale të roleve gjinore, të cilat vazhdojnë të ndikojnë shpërndarjen e përgjegjësive edukative edhe në kontekstin e teknologjisë digjitale.

Në këtë kuadër, prindërimi digjital pozitiv duhet të rikonceptohet si një proces i bazuar në dialog, fleksibilitet dhe prani emocionale, dhe jo si një praktikë e fokusuar kryesisht në kontrollin ose ndalimin e teknologjisë. Bashkëjetesa me teknologjinë shfaqet si më e qëndrueshme sesa përpjekjet për kufizim absolut.

## REFERENCAT

- Ajzen, I. (1991). The theory of planned behavior. *Organizational Behavior and Human Decision Processes*, 50(2), 179–211. [https://doi.org/10.1016/0749-5978\(91\)90020-T](https://doi.org/10.1016/0749-5978(91)90020-T)
- Baumrind, D. (1966). Effects of authoritative parental control on child behavior. *Child Development*, 37(4), 887–907. <https://doi.org/10.2307/1126611>
- Braun, V., & Clarke, V. (2006). Using thematic analysis in psychology. *Qualitative Research in Psychology*, 3(2), 77–101. <https://doi.org/10.1191/1478088706qp063oa>
- Bronfenbrenner, U. (1979). The ecology of human development: Experiments by nature and design. Harvard University Press.
- Clark, L. S. (2013). The parent app: Understanding families in the digital age. Oxford University Press.
- Clarke, V., & Braun, V. (2014). Thematic analysis. In T. Teo (Ed.), *Encyclopedia of critical psychology* (pp. 1947–1952). Springer.
- Daniels, E., & Willard, A. S. (2023). Curated selves: Adolescent identity performance on social media. *Journal of Adolescent Research*, 38(1), 22–41. <https://doi.org/10.1177/07435584221081222>
- Dürager, A., & Livingstone, S. (2012). How can parents support children's internet

- safety?. EU Kids Online, London School of Economics and Political Science.
- Elsaesser, C., Russell, B., Ohannessian, C. M., & Patton, D. (2017). Parenting in a digital age: A review of the role of parental monitoring in online risk exposure among youth. *Adolescence Research Review*, 2(1), 1–14.
- Festinger, L. (1954). A theory of social comparison processes. *Human Relations*, 7(2), 117–140.
- Fidan, N. K., & Olur, B. (2023). Examining the relationship between parents' digital parenting self-efficacy and digital parenting attitudes. *Education and Information Technologies*, 28(11), 15189–15204. <https://doi.org/10.1007/s10639-023-11841-2>
- Goffman, E. (1959/2016). *The presentation of self in everyday life*. Anchor Books.
- Guba, E. S., & Lincoln, Y. S. (1994). *Competing Paradigms in Qualitative Research*. In & Y. N.K. Denzin, *Handbook of qualitative research*. New York: SAGE Publishing.
- Guest G, Namey EE, Mitchell ML. *Collecting qualitative data: A field manual for applied research*. Thousand Oaks, California, USA: SAGE Publishing; 2013.
- Hennink MM, Kaiser BN, Marconi VC. Code saturation versus meaning saturation: How many interviewees are enough? *Qual Health Res*. 2017; 27:591–608. <https://doi.org/10.1177/1049732316665344>
- INSTAT (2024). Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit në familjet shqiptare. Tirana: Instituti i Statistikave.
- Kirwil, L. (2009). Parental mediation of children's internet use in different European countries. *Journal of Children and Media*, 3(4), 394–409.
- Livingstone, S., & Blum-Ross, A. (2020). *Parenting for a Digital Future: How Hopes and Fears about Technology Shape Children's Lives*. Oxford University Press.
- Livingstone, S., Haddon, L., Görzig, A., & Ólafsson, K. (2011). Risks and safety on the internet: The perspective of European children. London School of Economics and Political Science, EU Kids Online.
- Livingstone, S., Mascheroni, G., Dreier, M., Chaudron, S., & Lagae, K. (2015). How parents of young children manage digital devices at home: The role of income, education and parental style. European Commission Joint Research Centre.
- Livingstone, S., Ólafsson, K., Helsper, E. J., Lupiáñez-Villanueva, F., Veltri, G. A., & Folkvord, F. (2017). Maximizing opportunities and minimizing risks for children online: The role of digital skills in emerging strategies of parental mediation. *Journal of Communication*, 67(1), 82–105.
- Merriam, S.B. (2014) *Qualitative research: A guide to design and implementation*. New York: John Wiley & Sons
- Milford, S. C., Vernon, L., Scott, J. J., & Johnson, N. F. (2022). An initial investigation into parental perceptions surrounding the impact of mobile media usage on child behavior and executive functioning. *Human Behaviors and Emerging Technologies*. 2022, 1–11. <https://doi.org/10.1155/2022/1691382>
- Neumann, M. M. (2018). Maternal scaffolding of preschoolers' writing using tablet and paper-pencil tasks: Relations with emergent literacy skills. *Journal of Research in Childhood Education*, 32(1), 67–80. <https://doi.org/10.1080/02568543.2017.1386740>
- Schwandt, T. A. (2014). On the mutually informing relationship between practice and theory in evaluation. *American Journal of Evaluation*, 35(2), 231–236.
- Shehu, A., Danaj, E., Kocaqi, M., & Sulçe, V. (2023). Studimi për gratë në Republikën e Shqipërisë 2022–2023. UN Women Shqipëri & INSTAT.
- Smahel, D., Helsper, E. J., Green, L., Kalmus, V., Blinka, L., & Holloway, D. (2020). *EU Kids Online 2020: Survey results from 19 countries*. EU Kids Online Network.
- Soyoo, A., Reynolds, B. L., Neumann, M., Scull, J., Tour, E., & McLay, K. (2024). The impact

- of parent mediation on young children's home digital literacy practices and learning: A narrative review. *Journal of Computer Assisted Learning*, 40(1), 65–88. <https://doi.org/10.1111/jcal.12866>
- Strasburger, V. C., Hogan, M. J., Mulligan, D. A., Ameenuddin, N., Christakis, D. A., Cross, C., ... & Moreno, M. A. (2013). Children, adolescents, and the media. *Pediatrics*, 132(5), 958–961.
- Terras, M. M., & Ramsay, J. (2016). Family perspectives on social media and early learning: Balancing resources and risks. *British Journal of Educational Technology*, 47(5), 807–820.
- Vaismoradi, M., Turunen, H., & Bondas, T. (2013). Content analysis and thematic analysis: Implications for conducting a qualitative descriptive study. *Nursing & Health Sciences*, 15(3), 398–405. <https://doi.org/10.1111/nhs.12048>
- Valcke, M., Bonte, S., De Wever, B., & Rots, I. (2010). Internet parenting styles and the impact on Internet use of primary school children. *Computers & Education*, 55(2), 454–464.
- Vogels, E. A., Gelles-Watnick, R., & Massarat, N. (2022). Teens, social media and technology 2022. Pew Research Center. <https://www.pewresearch.org/internet/2022/08/10/teens-social-media-and-technology-2022/>
- Wang, R., & Lwin, M. O. (2017). Parental mediation and child outcomes in the digital age: A meta-analysis. *Journal of Communication*, 67(6), 862–894.
- Zheng, Y., Duff, B. R. L., Vargas, P. T., & Yao, M. Z. (2020). Idealized identity and social media: How and why young adults create false online representations. *Psychology of Popular Media*, 9(1), 35–43.

## ABSTRACT

The digital revolution has significantly transformed parenting practices and parent-child communication patterns, especially during adolescence, a period characterized by rapid developmental changes. This study aims to explore positive digital parenting practices as communication and interaction mechanisms that foster parent-child trust in the Albanian reality. A qualitative approach with an exploratory design was used to conduct this research, conducting 19 in-depth interviews and two focus groups with parents of adolescents aged 13-16 in the city of Tirana. The data collected during the period December 2024 -March 2025 were analyzed through thematic analysis. The main findings show that parents alternate between forms of active, restrictive mediation and covert monitoring, practices often influenced by uncertainty, cultural norms and low perception of parental control. The study highlights that open dialogue, flexibility and parental modeling are key elements for building trust and maintaining emotional connection in the digital environment. The analysis also reflects a gender divide in digital parenting, where mothers bear the main burden of daily mediation, while fathers tend to intervene mainly as an authority in situations perceived as serious. The paper concludes that positive digital parenting should be based on dialogue and emotional presence, emphasizing that coexistence with technology through understanding is more effective than attempts at absolute restriction. This research provides a scientific contribution by contextually analyzing digital parenting in Albania and the need for strategies based on mutual accountability.

**Keywords:** *Digital parenting, adolescence, parent-child communication, trust, social media*

## Guide for Authors

The journal “Studime Sociale” [Social Studies] is a scholarly journal published by the Albanian Institute of Sociology (AIS), associated with the Albanian Sociological Association (ALBSA). It has been certified as a scientific journal by the KVTA/MAS by Decision No. 170, dated December 20, 2010. The journal has also been classified as a scientific journal by ANVUR – the National Agency for the Evaluation of the University and Research System of the Italian Ministry of Education, Universities and Research (MIUR), by Decision No. 298, dated December 21, 2021. *Social Studies* has been published continuously since 1998. It is managed by an International Editorial Board and is published with code ISSN, in two formats: print and online. Articles may be published in Albanian or English.

The fundamental principle of publication is **scientific rigor**. Every manuscript submitted undergoes a **double-blind peer review process**. Each article is reviewed by **two anonymous scholars** in the relevant field(s), and publication is granted only if both reviews are positive. The selection of scientific articles is therefore the **exclusive responsibility of anonymous peer reviewers**.

The publication costs of the journal are covered by contributors, in proportion to the length of each article (pages, with 2,200 characters per page). If any issue or individual article is financially supported by a third party (individual or institution), this support is explicitly acknowledged.

Each article must comply with linguistic and academic standards and must constitute original work. Submissions may be either research articles or review articles. Manuscripts must be submitted in Word format and should follow this structure: (1) Title, up to 15 words; (2) Author/s (first name and surname); institutional affiliation(s); email address(es) for each author (3) Abstract, 200–250 words, with 4–6 keywords; (4) Author biography, approximately 50 words, in narrative form; (5) Main text; (6) Complete list of references, in alphabetical order by authors’ surnames (7).

Articles may include **footnotes** for specific explanations; however, footnotes should not be used for bibliographic references. The journal follows the **APA referencing system**, using **in-text citations** accompanied by a corresponding **alphabetically ordered reference list** at the end of the manuscript, based on authors’ surnames or the institutions responsible for the cited documents. The complete references listed at the end of the text must contain all elements necessary to identify the original sources, as follows:

- a. **Books:** Author(s); year of publication; *title of the book* (italicized); place of publication; publisher. *Example:*  
Merton, Robert. 1968. *Social Theory and Social Structure*. New York: Free Press.
- b. **Journal articles, book chapters, etc.:**  
Author(s); year of publication; “title of the article” (in quotation marks); *title of the journal or edited volume* (italicized); volume/issue and page range. *Example:*  
Buss, Loreta. 2010. “Childhood in Sociology and Society: The U.S. Perspective.” *Current Sociology*, Vol. 58, No. 2, pp. 350–355.
- c. **Archival documents:**  
In addition to the elements above, the reference should include the **archive, file, and folder/fascicle**.
- d. **Online sources:** In addition to the standard elements, the reference should include the **URL** and the **date of last access**.

All references listed at the end of the manuscript must correspond to the abbreviated in-text citations, which should follow these examples:

Single author: Weber (1998); (Weber, 1998: 156); Weber (1998: 156)

Two or three authors: (Lazarsfeld & Berelson, 1990); (Olzak, Shanahan & West, 1986)

More than three authors: (Larsen et al., 1989)

Multiple references: (Blau, 1980; Kadare, 1995; Uçi, 2003; Pëllumbi, 2004; Omari, 1999)

If an author has more than one publication in the same year, references should be distinguished as 2011a, 2011b, etc.

## Kriteret e botimit

Revista “Studime Sociale” është revistë e Institutit Shqiptar të Sociologjisë (AIS), i asociuar me Shoqatën Sociologjike Shqiptare (ALBSA). Ajo është certifikuar si revistë shkencore nga KVTA/MAS me vendim Nr. 170, datë 20. 12. 2010. Ajo është klasifikuar si revistë shkencore nga ANVUR - Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor i Ministrisë së Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor të Italisë (MIUR) me vendim Nr. 298, datë 21 dhjetor 2021.

Revista “Studime Sociale” botohet pa ndërprerje nga viti 1998. Ajo drejtohet nga bordi botues ndërkombëtar dhe botohet me kod ISSN, në dy forma: print dhe online. Artikujt mund të botohen në shqip ose anglisht.

Parimi bazë i botimit është rigoroziteti shkencor. Çdo artikull i nënshtrohet një recensionimi të verbër (**double-blind peer review**). Ai u jepet për recensionim dy studiuesve të fushave të afërta dhe artikulli botohet nëse recensat janë pozitive. Pra, detyra e përzgjedhjes së artikujve shkencorë është kompetencë ekskluzive e recensentëve anonimë.

Kostoja e revistës përballohet nga kontribuuesit sipas vëllimit të çdo artikulli (faqe me nga 2200 karaktere). Nëse ndonjë numër, apo artikull i veçantë i revistës, financohen nga ndonjë subjekt (individ apo institucion) në çdo rast bëhet shënimi përkatës.

Çdo artikull duhet të jetë në përputhje me standardet gjuhësore. Artikujt duhet të jenë krijime origjinale. Ato mund të jenë artikuj shkencorë ose recensionues. Artikujt shkencorë duhet të dërgohet në word me këtë strukturë: (1) titulli, deri në 15 fjalë; (2) autori/autorët (emri mbiemri); institucioni ku është/janë; adresat elektronike – për çdonjërin prej tyre; (3) përmbledhje (shqip), me 200-250 fjalë dhe 4-6 fjalë kyçe; (4) të dhëna për autorin/autorët, rreth 50 fjalë, si tekst; (5) teksti; (6) Referencat e plota, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve; (7) abstract në anglisht (varianti anglisht i përmbledhjes).

Artikulli mund të shoqërohet me shënime në fund të faqes (footnotes) për ndonjë shpjegim të veçantë. Por ato nuk janë referenca. *Sistemi i referencave të revistës është sistemi i APA*, me referenca të shkurtuara përgjatë tekstit, shoqëruar me listën korresponduese të referencave të plota në fund të tekstit, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve, apo institucioneve që kanë autorësinë.

Referencat e plota në fund të tekstit duhet të përbëjnë elementë (të dhëna) që të adresojnë te burimet origjinale:

- a. Për librat: autori/ose autorët (1); viti i botimit (2); titulli i librit, në korsiv (3); ku është botuar (4) dhe botuesi (5).  
P.sh. Merton, Robert. 1968. *Social Theory and Social Structure*, New York: Free Press.
- b. Për artikuj nga revistat shkencore, kapituj librash etj.: autori/autorët (1); viti i botimit (2); titulli i artikullit, në thonjëza (3); titulli i revistës/përmbledhjes ku është botuar, në kursiv (4); revista apo botimi ku gjendet e faqet, nga-deri (5).  
P.sh.: Buss, Loreta. 2010. “Childhood in Sociology and Society; The US Perspective”, *Currant Sociology*, Vol. 58, No. 2, pp. 355-350.
- c. Për dokumente arkivorë shtohet (pika 5) Arkivi, Dosja, fashikulli.
- d. Për dokumente të marrë nga interneti shtohet (pika 5) link-u dhe data e fundit kur është parë.

Referencat e plota, të listuara në fund të tekstit, duhet të korrespondojnë me referencat e shkurtuara nëpër tekst, të cilat vendosen si në shembujt: Për një autor: Weber (1998); (Weber, 1998: 156); ose Weber (1998: 156); Për dy dhe tre autorë: (Lazesfeld & Berelson, 1990) e (Olzak, Shanahan & West, 1986); Për më shumë se tre autorë: (Larsen ed al., 1989); për seritë e referencave (Blau, 1980; Kadare, 1995; Uçi, 2003; Pëllumbi, 2004; Omari, 1999). Në qoftë se për të njëjtin autor ka më shumë se një referencë në të njëjtin vit, atëherë shënohet: 2011a, 2011b.